



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 5 SHKURT 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5. FEBRUARA 2015. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së për përgjegjësinë e ministrit Aleksandër Jablanoviq për deklaratat e tij publike,
5. Projekt-rezoluta për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës,
6. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,
7. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për emërimin e anëtarit në komisionin parlamentar,
8. Propozimi i Grupit Parlamentar të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarit në komisionin parlamentar.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Interpelacija premijera Isa Mustafa prema zahtevu Parlamentarne grupe AAK, o odgovornosti ministra Aleksandar Jablanović za njegove javne zjave,
5. Predlog-rezolucija o sprečavanju ilegalne migracije građana Kosova,
6. Predlog za formiranje ad hoc komisije za izbor članova Nezavisne komisije za medije,
7. Predlog Parlamentarne grupe Pokreta “Samoopredeljene” za imenovanje člana u parlamentarnoj komisiji,
8. Predlog Parlamentarne grupe Srpska lista za zamenjivanje člana u parlamentarnoj komisiji.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Atëherë fillojmë me pikat e rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka kërkuar Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit të Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë sot e marr fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe do të diskutoj për situatën që po jetojmë tani dhe zgjidhjet përtej interesave partiake.

Është interes kombëtar dhe shtetëror që të jemi unikë, të mos u qasemi problemeve me politika ditore dhe me probleme të grupacioneve, por të merremi seriozisht me probleme thelbësore që e rëndojnë shoqërinë tonë dita-ditës.

Prandaj, duhet të bëhemi bashkë pozitë e opozitë dhe për ideal ta kemi shtetndërtimin, duke i luftuar dukuritë negative që nuk i duhen vendit tonë.

Të krijojmë ambient të sigurt duke e zbatuar ligjin në të gjitha instancat nëpërmjet mekanizmave raportues ligjorë.

Gjendja e krijuar pas zgjedhjeve të lira e demokratike të 8 qershorit 2014 e krijoi një stagnim politik për 6 muaj. Ky stagnim nxori si rezultat mosbesimin brenda politikës kosovare.

Së bashku mund dhe duhet të punojmë shumë për ta kthyer shpresën e qytetarëve të vendit tonë, të jemi komunikues ndaj qytetarëve tanë, si pozita, ashtu edhe opozita.

Gjendja e rëndë sociale ka shtyrë shumë të rinj dhe familje të tëra që të emigrojnë, e këtu hyjnë edhe ata që janë me përgatitje të lartë profesionale të ndryshme, si juristë, ekonomistë, mjekë, mësimdhënës e të tjerë, pasi nuk kanë parë dhe nuk shihet perspektivë në vendin e tyre.

Pasiguria sociale edhe politike është një shtysë tjetër drejt migrimit të të gjitha shtresave. Kur them pasiguri sociale, përveç stagnimit politik, që ishte gjashtë muaj më parë rresht, bazohem sidomos edhe në ngjarjet e fundit - protestat, që tronditën me vandalizmin dhe me sulmin ndaj forcave të rendit, kur nga një protestë e paralajmëruar paqësore përfundoi në një marketing politik dhe në një shkatërrim të pronës shtetërore private, me të lënduar, si qytetarë, ashtu edhe policë.

Shqetësim shumë i madh për ne duhet të jetë edhe një lloj tjetër i migrimit shumë i dhimbshëm - shkuarja e mjekëve dhe profesioneve tjera në Perëndim, në kërkim të jetës atje.

Në vend se t'i inkurajojmë kategoritë e mjekëve dhe të ekspertëve që punojnë në kushte jo të favorshme, ne qëndrojmë gojëmbyllur për zyrtarët e shtetit tonë që marrin dy-tri, apo më shumë paga.

Unë po e marr shembull Universitetin e Prishtinës, ku është krijuar një strukturë e tërë profesorësh, e shumë nga ata merren me politikë, ku kanë ndërtuar piramida udhëheqjeje, duke ndarë poste, e për një shumicë profesorësh kanë krijuar pozita false, vetëm sa për t'i shpërndarë honorarët dhe mëditjet si linjë buxhetore lehtë e identifikueshme për ne. Kemi edhe shumë raste të tjera.

Diku, sipas raportit të ministrit për Financa, kohë më parë, 50 milionë euro nga Buxheti i Kosovës shkojnë për mëditje dhe shtesa në çdo vit.

Largimi i të rinjve, e sidomos intelektualëve dhe i ekspertëve të fushave të ndryshme është një çështje për të cilën duhet të mendojmë dhe të diskutojmë, pasi nuk mund t'ia lejojmë vetes ikjen e trurit nga Kosova, përderisa kemi nevojë urgjente që ekspertë të jenë këtu dhe të japin kontributin e tyre për përmirësimin e gjendjen në fushatë përkatëse.

Kjo energji negative, e mbledhur në një kohë të qytetarët tanë, shfrytëzimi i kësaj energjie për qëllime të caktuara, vetëm sa e përkeqëson gjendjen edhe kështu të rënduar të qytetarëve. Një fjalë e urtë thotë: "Pika-pika mbushet pusi!".

Ne jemi ballafaquar dhe jemi përballur me situata shumë më të vështira dhe kemi arritur t'i tejkalojmë me sukses ato.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju ftoj që të jemi pjesë e konsultave, diskutimeve konstruktive, të cilat e preken direkt çështjen socio-ekonomike të vendit dhe të jemi pjesë e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Më vjen keq, por në qoftë se do të shkojmë me radhë për të mos humbur kohë, a është dikush nga Grupi Parlamentar i LDK-së? Atëherë, nga deputetët Nuredin Ibishi është lajmëruar i pari.

NUREDIN IBISHI: I nderuari zoti kryetar,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Kabinet qeveritarë,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar të pranishëm dhe qytetarë,
Dua të flas lidhur me ngecjen e zhvillimeve të Malësisë së Gollakut.

Pra, Malësia e Gollakut si një vend që shtrihet në lindje të Kosovës, në sipërfaqe prej më shumë se 10% të territorit të Kosovës dhe si e tillë është pjesa më e pazhvilluar e vendit tonë. Edhe gati pas 16 vjetëve të pasluftës ky rajon kufitar nuk e ka marrë trajtimin e duhur, edhe pse ka qenë e ditur kaherë se kjo pjesë karakterizohet si zona më e izoluar dhe më e pazhvilluar e Kosovës, ende asnjëherë nuk është bërë një ndërmarrje për punësimin serioz ekonomik të kësaj treve.

Gollaku si trevë kufizohet me Llapin, Rrafshin e Kosovës, Anamoravën, si dhe me Karadakun, dhe e ka një shtrirje të vendbanimeve të veta nëpër këto komuna: Podujevë, Prishtinë, Novobërdë, Gjilan dhe Kamenicë.

Numri i fshatrave të Gollakut është 110 sosh, prej tyre 15 në brezin kufitar me Serbinë. Pas vitit 1999 ka pasur një migrim të madh të popullatës dhe pothuajse në tërë fshatrat e Gollakut numri i banorëve ka rënë gati në 5%, krahasuar me gjendjen e para 16 vjetëve.

Shumica e këtyre banorëve janë vendosur në pjesë urbane të qyteteve të lartpërmendura, pra këtyre qendrave komunale, dhe kjo përbën një shpresë dhe potencial që me zhvillimin e kësaj treve shumë nga këta banorë, nëse investohet në të ardhmen, mund të kthehen sërish në malësinë e tyre.

Mos zhvillimi ekonomik, e sidomos mungesa e infrastrukturës, ka bërë që shumë fshatra të braktisen nga banorët dhe tani është krijuar një gjendje me disa vendbanime pothuajse të zbrazura. Një numër i madh i fshatrave ka mbetur me dy apo tri shtëpi.

Rajoni i Malësisë së Gollakut në vazhdimësi është lënë anash, si në aspektin e zhvillimit ekonomik, po ashtu edhe atë infrastrukturor.

Me theks të veçantë dua të pohoj se deri tash nuk është ndërmarrë asgjë në ngritjen e marrëdhënie fqinjësore dhe të bashkëpunimit ndërkufitar me bashkëkombësit tanë që jetojnë në Medvegje dhe Bujanoc.

Kjo në masë të konsiderueshme ka ndikuar që të vijë deri te shpërngulja e madhe e shqiptarëve në të dyja anët e kufirit dhe lidhur me këtë po ashtu nuk janë aplikuar marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërkufitar, ashtu sikur janë të përcaktuara standardet dhe praktikatat më të mira evropiane.

Ne duhet ta avancojmë bashkëpunimin ndërmjet popullatës shumicë të shqiptarëve në këtë anë të kufirit dhe pjesës tjetër të shqiptarëve të komunave Medvegje, Bujanoc dhe Preshevë.

Pra, deri tash nuk është ndërmarrë asgjë për rritjen e bashkëpunimit, si në investime me mundësi të mbështetjes së brendshme për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik-social kulturor e sportiv, që do të ndikonin në relaksim të marrëdhënieve ndërkufitare dhe ndëretnike. Madje, as që është kërkuar ndonjëherë asistencë dhe mbështetje për projekte dhe fonde të caktuara evropiane për përparimin dhe ngritjen e këtij bashkëpunimi.

Nuk duhet harruar se edhe Pakoja e Ahtisarit ka afruar mundësi për këtë bashkëpunim. Ky favor në vazhdimësi është shfrytëzuar nga serbët e Kosovës, duke përfituar fonde të veçanta nga taksat me privilegje dhe beneficione tjera.

Shqiptarët e anës tjetër të kufirit, përpos që nuk kanë kurrfarë beneficimesh, ata vazhdojnë të ngarkohen me shuma të larta të sigurimeve të automjeteve, ndërsa serbët lirohet prej tyre, duke i shfrytëzuar sistemet paralele të regjistrimeve.

Se sa janë të avancuara dhe të lartësuar këto marrëdhënie ndërkufitare ndërmjet shumicës dhe pakicës që jeton në shtetin tjetër përmenden si praktika të mira. Përfitime që gëzon pakica gjermane në praktikën evropiane, e cila jeton në Danimarkë, dhe ajo daneze në Gjermani.

Lirimi nga taksat, benifitet lidhur me mirëqenien sociale, punësimi, shkollimi, prandaj shumë shtetas gjermanë dëshirojnë të jenë pakicë në Danimarkë dhe anasjelltas për danezët.

Edhe pse është nënshkruar marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufirit me Serbinë, deri tash në këtë zonë të Gallapit është vetëm një kalim kufitar, pra edhe një pikë doganor në Republikën e Serbisë, dhe kjo është pika kufitare e Mutivodës. Është e domosdoshme që të hapen edhe dy kalime kufitare, që dikur ishin drejtime shumë frekuentuese të komunikimit rrugor, njëra në Bërvenik dhe tjetra te Kapia.

Derisa në disa komuna, ku shtrihet Gollaku, dalin me suficit buxhetor nga vitet e kaluara, infrastruktura rrugore mbetet e papërfunduar në këto akse rrugore: Ballaban-Orllan, Orlan-Nishevc, Marec-Krilevë, Koliq-Viti e Marecit, Koliq-Sharban, Lisockë-Gëmicë-Shahiq, Firiqevë-Gjyriqevc-Gëmicë. Fshatrat në të cilët deri tash nuk është ndërtuar asnjë rrugë e asfaltuar janë të shumtë, sikur që është Kushevica, Nisheci, Bllaca, Metërgoci, Rakinica, Shahiqi, Zhuja, Gëmica e tjera. Duhet të përmend se aty ku janë ndërtuar deri tani rrugët dhe infrastruktura tjetër, aty edhe ka filluar kthimi i njerëzve dhe ka filluar gjallërimi ekonomik.

Është pikërisht kjo pjesë e Kosovës me shumë burime minerale nëntokësore, me xeheroret në Surdullë, Novobërdë, Strezoc e Badoc...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Më vjen keq! Aida Dërguti, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

AIDA DËRGUTI: Deputetë të Kuvendit,
Qytetarë të Republikës,
Janë dy lloj protestash që gjatë janarit e mbuluan Kosovën.

E para, në rrugët e sheshit të qyteteve dhe kryeqytetit të Kosovës dhe e dyta është protestë e heshtur, e cila po vazhdon në drejtim të Hungarisë. Që të dyja protestat i kanë të përbashkëta pakënaqësitë e akumuluar ndërsa vite, por që manifestohen në mënyra të ndryshme. Protestuesit e shesheve, të vetëdijshëm që nuk ekziston një atdhe i dytë, kanë vendosur të qëndrojnë dhe të ballafaqohen me problemet e shumta të këtij vendi, duke i kthyer në kërkesa konkrete dhe duke i adresuar me radhë para Qeverisë.

Ndërkaq, protestuesit e heshtur pavetëdijshëm po e rrënojnë imazhin e rrejtshëm të lumtur të evropianëve të rinj. Ata e kanë humbur çdo shpresë, të cilët duke sharë e mallkuar, i bashkohen eksodit të varfërisë, për ta ndërtuar larg atdheut të tyre atë që ju ka mbetur nga jeta dhe t’u japin një mundësi për jetë më të mirë fëmijëve që i mbajnë në krahë në këtë rrugëtim të dhimbshëm e të mundimshëm. Qytetarët nuk duhet fajësuar. Të drejtën për jetë dhe mirëqenie nuk mund t’ua mohojë askush, aq më pak shteti, i cili nuk është në gjendje t’ua sigurojë as kafshatën e gojës.

Të freskëta i kemi imazhet e qershorit të vitit 1999, kur po këta qytetarë e çuditnin botën duke u kthyer vullnetarisht në Kosovë nëpër tenda që i vendosnin pran themeleve të shtëpive të tyre, të bëra shkrumb e hir. Nuk duhet harruar se deri para disa vitesh qytetarët e Kosovës rangoheshin si populli më optimist në botë. Janë po këta qytetarë të zellshëm e të durueshëm që ndër vite dhanë shumë për këtë vend. Për 15 vjet politikëbërja e gabuar ua vrau shpresat. Për kolltukët e kësaj salle dhe ato të Qeverisë është paguar çmim jashtëzakonisht i lartë me jetën e shumë dëshmorëve dhe viktimave civile. Po ashtu me sakrificën e vuajtjet e secilit qytetar, që vendosi të qëndrojë në Kosovë, kundruall të gjitha vështirësive në kohën e regjimit të Milosheviqit, në kohën e luftës, e deri në ditët e sotme, kur e kanë të pamundur ta sigurojnë një burim të ekzistencës për familjet e tyre.

Në këtë varfëri të thellë, përsëri janë po këta qytetarë, që njëkohësisht janë edhe taksapagues që e mbushin buxhetin e shtetit, mbajnë mbi supet e tyre të gjitha institucionet e Kosovës, të cilat, përveç shpenzimit të buxhetit, nuk marrin mundin ta zgjidhin as edhe njërën nga problemet e shumta të qytetarëve.

Zhvendosja e prioritetëve nga një legjitim populist nëpër fushata zgjedhore me premtimet e shumta për vende pune, përfundon me zbatim të një agjende të huaj në qeverisje rreth një dialogu në dëm të vendit, që për pasojë ka zhbërjen e shtetit dhe katandisjen e popullit në mjerim. Kundruall këtyre dy protestave, shpërfaqen dy forma të dhunës shtetërore: dhuna brutale ndaj protestuesve të shesheve dhe dhuna e padukshme dhe sistematike ndaj protestuesve të heshtur, që për 15 vjet nuk ua siguroi kafshatën e bukës.

Gjatë muajit janar, Qeveria e Republikës së Kosovës u përball me dy kërkesa të qytetarëve protestues: shkarkimi i ministrit Jabllanoviq dhe mbrojtja e “Trepçës” me ligj të veçantë. Përderisa protesta ndodhnin gjithandej Kosovës, kryeministri mendonte se me heshtje do ta tejkalonte situatën, duke shpresuar se qytetarët do të lodheshin dhe protesta do të shuhej. Mirëpo, në këtë kohë të rëndë për Kosovën, kur edhe barra buxhetore për Ministrinë e Kthimit është e pakuptimit përballë këtij eksodi masiv të qytetarëve për arsye socio-ekonomike, fyerja e këmishëziut Jablanoviq ishte e patolerueshme. Indiferenca e Qeverisë, derisa protestohej në shumë qytete të Kosovës, u kthye në ankth dhe frikë të humbjes së pushtetit, kur protesta u zhvendos në Prishtinë.

Pafuqia në marrjen e vendimit për shkarkimin e Jablanoviqit dhe paranoja e humbjes së pushtetit u përkthye në një dhunë brutale policore ndaj protestuesve dhe kalimtarëve të rastit. Mungesa e numrave identifikues të policëve, përdorimi i forcës joproporcionale gjatë arrestimit, sharjet dhe kërcënimet, përfshirë edhe ato me armë zjarri, rrahjet brenda stacionit të Policisë janë disa nga dëshmitë për tejkalim kompetencash dhe shkelje të rënda ligjore nga Policia.

Kjo dhunë e shpërfaqur mund të cilësohet si tendencë për shuarjen e institucionit të protestës. Hetimi i tërë zinxhirit komandues është i domosdoshëm, derisa të gjendet se në cilën hallkë ishte urdhërdhënia për këto veprime të kundërligjshme. Llogaridhënia para qytetarëve është e domosdoshme. Shkarkimi i Jablanoviqit dëshmon se kërkesat ishin legjitime, andaj kërkojmë që vendimi për shkarkim të publikohet menjëherë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Të nderuar deputetë, Largimi i Jablanoviqit, dje a pardje, natyrisht që është një veprim i mirë. Dikush thotë është bërë herët, dikush thotë është vonë, por si do që të jetë mendoj që është një veprim i mirë edhe një veprim i domosdoshëm, të cilin Qeveria është dashur ta ndërmarrë dhe për të cilin ka pasur përgjegjësi. Mirëpo, me gjasë po harrojmë që ka edhe shumë veprime tjera të ndërhyrjes direkte të Beogradit në punën e institucioneve të Kosovës dhe në jetën politike në Kosovë, e të cilat sikur po kalojnë heshtazi, që fatkeqësisht janë veprime shumë të rënda, janë veprime të cilat po lënë gjurmë në planin politik e juridik të vendit tonë.

Ndërhyrja juridike e politike ka të bëjë me emërimin e kryetarit të Komunës së Shtërpçës nga kryeministri i Serbisë si kryetar paralel, unë do të thosha, në fakt, jo kryetar paralel, por është një kryetar të cilin e ka emëruar Serbia, se nuk është paralel hiç, është ndërhyrje direkte e Serbisë me këtë veprim dhe kurrkujt kurrgjë.

Qeveria, fatkeqësisht, po kërkon ndihmë edhe nga Serbia, edhe nga Brukseli. Nga Serbia po kërkon ndihmë për ta ndalë migrimin e qytetarëve shqiptarë, sepse vetë me gjasë nuk po e sheh të arsyeshme që të marrë ndonjë veprim, kurse nga Brukseli kërkon që t'i ndalë

veprimet e Serbisë në Kosovë për emërimin apo për strukturat paralele, t'i quajmë ashtu të Serbisë, apo strukturat e Serbisë në Kosovë. Jo strukturat paralele, por strukturat e Serbisë në Kosovë!

Zonja Tahiri, para do ditësh, po më vjen keq që unë duhet ta them, por dikush duhet ta thotë më në fund, kërkoi nga Brukseli që të kërkojë nga Vuçiqi të mos bëjë emërimet të kryetarëve të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Zonja Tahiri, po më vjen keq, doli si duket, kisha pasur dëshirë të jetë këtu, ndoshta na dëgjon, por po më vjen keq që ka mbetur në atë terminologjinë e viteve të '90-ta. Në vitet e '90-ta ne kemi pasur arsye për ta thirrur Evropën e Botën që të na ndihmojnë se nuk kemi qenë shtet i pranuar.

Sot, 8 vjet pas pavarësisë së Kosovës, të kërkohet nga Brukseli dhe nga Beogradi që të na i kryejnë punët tona, kjo me të vërtetë është e pa logjikshme, e paarsyeshme dhe jo veç e palogjikshme dhe e paarsyeshme, por është shumë e rrezikshme. Është shumë e rrezikshme për funksionimin e shtetit tonë. 8 vjet pas pavarësisë, zonja Tahiri kërkon nga Brukseli: 'allahile, ndaleni Vuçiqin!'. Ku është veprimi i shtetit tonë? Ku është veprimi i institucioneve shtetërore të shtetit të pavarur të Kosovës 8 vjet pas pavarësisë? Asnjë veprim. Ajo flluska e borës, që thoshte, e shkreta është ngrirë. Na thoshin se do të shkrihet shpejt, por është ngrirë katastrofë dhe ka mbetur e ngrirë. Këto veprime duhet ndaluar.

A e kemi ne një shtet real, apo e kemi një shtet fiktiv? Me këto veprime, të cilat po shihen, apo edhe mosveprime, në fakt po del që kemi shtet fiktiv. Kjo është katastrofave, prandaj nuk duhet për t'u çuditur pse qytetarët tanë dhe kushdo qoftë tjetër bëjnë veprime të tilla në këtë vend. Edhe ndërhyrjet e të huajve e tjera e tjera. Sepse na po e japim imazhin i një shteti fiktiv, e jo të një shteti real. Fatkeqësisht apo fatmirësisht, nuk e di, shumë më shumë kemi qenë shtet në vitet e '90-ta dhe menjëherë pas lufte se sa që jemi shtet pas pavarësisë së Kosovës! Sesa po tregojmë fuqi shtetërore! Domethënë mungon forca politike për ta treguar fuqinë shtetërore, jo për të ushtruar dhunë, jo për të rrahur njerëz, por për ta treguar fuqinë institucionale të shtetit të pavarur të Kosovës.

Kjo mendoj, edhe sot këtu po shihet, se është njëllor sjellje sikur nuk ka ndodhur asgjë dhe sikur nuk po ndodh asgjë. Të gjitha ato veprime, të gjitha ato ndërhyrje, krejt kjo situatë brenda këtu, kurse sjellja jonë është sikur nuk po ndodh asgjë. Ju lutem shumë, neve na duhet shumë punë. Një rezultat e kemi mbërri, e ka mbërri Qeveria jonë. E ka bërë këtë shtatoren e 'Kral Milutinit' në Prishtinë! Nuk po i them Graçanicë, por në Prishtinë. Dhe, natyrisht këto janë probleme shumë serioze.

Zoti Kadri Veseli...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kërkoj falje, nuk varet nga unë. Reagojnë të tjerët, sepse unë ju kisha lënë sa të doni. Hajde edhe gjysmë minute, apo një minutë, të mos krijojmë keqkuptime.

MELIHATE TËRMKOLLI: Zoti Kadri Veseli, ende nuk po di mirë të ma thotë mbiemrin, por nuk ka problem. Nuk e kam atë problem, se problemi është se në ato listat e SHIK-ut me gjasë ashtu ma kanë mësuar dhe ka mbetur ashtu, prandaj rregullojeni, përmirësojeni dhe nuk e di a ju duhet më? Ndoshta ju duhet, prandaj përmirësojeni!

Kadri Veseli, Azem Sylja, Adem Grabovci thanë se duhet të hiqet Jablanoviqi. Shumë në rregull, shumë mirë! Por, folën krejt pa lidhje, sepse thanë që po t'i kishim fyer ne serbët, do të kishim dhënë dorëheqje. Unë e di se ju kurrë nuk do t'i kishit fyer serbët dhe krejt e dimë këtë, por ka shumë arsye të tjera që nuk duhet patjetër për t'i fyer serbët për të dhënë dorëheqje. Prandaj, ju kisha lutur shumë - jepni dorëheqje! Jepni dorëheqje, sepse ka shumë arsye. Mbi të gjitha, janë vrasjet politike për të cilat ende nuk keni thënë kurrgjë, e duhet të thoni.

KRYETARI: Faleminderit shumë! Kërkoj falje, por emrin e kam të shkruar kështu: zonja T-ë-r-m-k-o-ll-i, e në gjuhën shqipe lexohet Tërmkolli. E dyta, kisha dëshiruar që foltoret zakonisht të mos përdoren për çështjet të cilat nuk na takojnë këtu. E do nderi i deputetit dhe e do përgjegjësia profesionale, drejtohuni organeve kompetente për arsye që 15 vjet e terrorizoni opinionin e nuk shkoni në Prokurori. Ke të drejtë, por drejtohuni në Prokurori, e mos qesh se nuk është mirë, për arsye se njerëzit kanë pësuar. Të lutem!

Ju lutem, në emër të Grupit Parlamentar "6+", Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Poštovani,

Pitanje priznavanje diploma je jedno od pitanja koja i dalje nije rešeno, a koja se tiče velikog broja intelektualaca. Postoje dve grupe problema koji sa sobom nose različite specifičnost pitanje pred priznavanje diploma sa mitrovačkog Univerziteta i pitanja diploma stečenih u pojedinim državama u regionu. Nerešavanju problema priznavanje diploma stečenih na Univerzitetu u Mitrovici radilo se sa strane formiranog Vladinog tima, i pomoći koje je njima pružano od strane organizacije ECNI, naravno uz pomoć intelektualaca i nevladinog sektora.

Rešenje do koga se došlo se naziva prelaznim, vremenski limitirano, uz mogućnosti produženja ukoliko za to bude bilo potrebno. Odnosi se na sledeće: diplome stečene na mitrovačkom Univerzitetu neće se nostrifikovati, nego će se vlasnicima tih diploma priznati stečeno zvanje od strane komisija koja će formirati. Momentom priznavanja zvanja, osobe će moći aplicirati na posao u svim javnim institucijama, i biće na istom rangju kao i sve ostale vladine diplome u našoj državi. Jednom rečju biće jednako konkurenti na tržištu rada kao i svi ostali. Uz pomoć stručnjake iz Vladinog tima, MONTA i stručnjaka samog Univerziteta, ova procedura će imati svoj tok i vremensko trajanje.

Ovim potezom, donošenjem normativnog akta vezano za ovu problematiku, ne krši se nijedan zakon, ni Ustav naše države, i ovo bi trebalo trajati sve do konačnog rešavanja statuta Univerziteta u Mitrovici i njegovog akreditovanja od strane naše države.

Ovo do sada naizgled nerešivo pitanje je našla mogućnost svog rešavanja, nalazi se napisano na papiru i čeka potpis premijera, zato ga je sada sa ovog mesta molim, u svoje ime i u ime svih onih koji imaju ovaj problem, da se da konačni pečat ovaj inicijativi, i ovom prelaznom rešenju. Takođe ga molim da produži mandate angažovanjem stručnjacima da nastave svoj rad i pomognu nam u donošenju ovakvog sličnog rešenja za diplome stečene u pojedinim državama regiona.

Postoje opcije za ovu problematiku. Ja sam lično razgovarala sa mnogim institucijama i kompetentnim ljudima, naravno sa ministrom obrazovanja i gospođom Editom Tahiri. Molim vas da razumete i uložite energiju za ovu problematiku, bilo kakvo rešenje, pa i ovakvo prolazna za nas je početak rešavanja ovog momenta, do ovog momenta nečega nerešivo. Hvala!

KRYETARI: Valdete Bajrami, nga Grupi Parlamentar “Nisma”, e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Të nderuar qytetarë,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Sot po ju drejtohem Koalicion Qeveritar. Pse ju nënshtruat Listës serbe për një muaj rresht? Pse nuk e morët vendimin për shkarkimin e ministrit nga radhët e Listës serbe, menjëherë pas deklarimit të tij? Pse kaq gjatë nuk e morët një vendim, ashtu siç u kërkua nga mijëra qytetarë? Kush ishte pengesa, që juve ju desh një muaj kohë ta merrni një vendim, i cili do t’i ndalte protestat dhe vendim, i cili do t’i qetësonte jo vetëm nënat gjakovare, po të gjitha nënat në tërë Kosovën, të cilat kanë humbur më të dashurit e tyre.

Po ta kishit marrë një vendim me kohë, nuk do të kishit aq numër të madh të lënduarve, por nuk do t’i kishit edhe ato dëme materiale, për të cilat u bë shumë bujë e madhe, sa që do t’i kushtonit kujdes gjendjes së qytetarëve tanë, të cilët po largohen nga vendi, aq sa jeni duke u marrë me dëmet e objektit të Qeverisë.

Por, sido që të jetë, kjo situatë të cilën e përjetuan qytetarët duhet të jetë mësim për gjithë Kabinetin qeveritar, që të jenë të kujdesshëm në punën dhe veprimet e tyre, se populli do t’ ju ndëshkojë në rast se do të punoni në kundërshtim me vullnetin e tyre.

Zoti kryeministër, nga prononcimet tuaja së bashku me kryeministrin Thaçi, po e them kryeministrin Thaçi, pasi që nuk po e kemi idenë se sa kryeministra i ka vendi ynë, në konferencë për shtyp ju thatë: “Këto protesta janë një tentativë për të marrë pushtetin me dhunë”. I keni quajtur “protesta të motivuara politikisht”, po si të mos jenë protesta të motivuara politikisht, kur e gjithë e ardhmja e qytetarëve po varet nga politika, të cilën për një kohë të gjatë e ka udhëhequr vartësi juaj, Hashim Thaçi, nga politika, siç keni thënë edhe vetë ju, politika e Hashim Thaçit që e ka kapur gjithë shtetin. Dy protestat ju kanë dhënë një leksion juve dhe partnerit tuaj për të ardhmen, që të keni kujdes se si i trajtoni çështjet me rëndësi nacionale.

E gjithë kjo gjendje e krijuar nuk është e ditëve të fundit, është shumë më e hershme dhe për këtë mund të them lirisht, se është përgjegjës partneri juaj i koalicionit. Andaj, mos e

ndiqni shembullin e keq të tij. Ndoshta, dikujt po i konvenon, që vendi ynë të japë një imazh jo të mirë e kjo, mund të them, se ju shkon përshtati atyre që kanë kapur çdo cep të formave demokratike dhe me doemos, duhet ta përmend se ka arritur që edhe Policinë e Kosovës, ta kapë dhe ta kthejë në kundërshtar për popullin dhe jo mbrojtës të tyre.

Zoti kryeministër, në deklaratën tuaj, më saktësisht më 4 qershor 2014, kur ju jeni pyetur se a do të bëni koalicion me PDK-në e Hashim Thaçit, po citoj deklarin tuaj: “Ne nuk bëjmë koalicion me njerëz, që e kanë ngulfatur shtetin, e kanë kapur shtetin, e kanë lëshuar rrjetin e strukturave aq thellë nëpër tërë organizmin, në medie, në kompani publike, në institucione qeveritare, në agjenci, në polici, në Prokurori, në gjyqësi.”.

Zoti kryeministër, nga kjo deklaratë e juaja po del, se ju në atë kohë nuk do të pranoni të ishit pjesë e keqkëqerisjes dhe e kapjes së shtetit, por, ju lutem të na tregoni sot, çfarë është situata me Policinë e Kosovës? A është Policia e kapur tash edhe nga ju, siç ishte e kapur edhe nga partneri juaj i koalicionit?

Kjo është shumë e dhembshme. Keni arritur që të krijoni në mes të popullit dhe Policisë, urrejtje, duke dhënë urdhra me ndikim politik, urdhra të cilët i ka marrë në ditën e protestën, Policia e Kosovës.

Çfarë është situata me mediet? A po vazhdon avazi i partnerit tuaj, që edhe ju të shtroni presion në medie dhe të mos lejoni shprehjen e lirë të tyre, se deri më sot është shumë e qartë, se mediet si elektronike ashtu edhe ato të shkruara, janë të ndikuara dhe të censuruara. Jeni në shërbim vetëm të Hashim Thaçit dhe tash sigurt edhe në shërbim tuajin, pasi që keni konfirmuar edhe ju se jeni pro censurës dhe kundër shprehjes së lirë.

Andaj, kryeministër, merre seriozisht postin që ta ka dhënë marrëveshja me partnerin tuaj dhe fillo të punosh në udhëheqjen e vendit, se vendi nuk udhëhiqet me postime në Facebook, por duhet t’i përvishni mëngët dhe t’i realizoni ato punë, të cilat jeni zotuar. Ju presin veteranët, ju presin mësimdhënësit, ju presin mantelbardhët, ju presin sindikalistët, prandaj përvishuni punës dhe definoni njëherë e mirë, se kush është kryeministër në vendin tonë.

Nisma, falënderon të gjithë qytetarët për pjesëmarrjen e tyre në protesta, veçanërisht aktivistët dhe simpatizantët e Nismës. Këto dy protesta, të nderuar qytetarë, sollën largimin e Jabllanoviqit e jo, siç deklaroi ministri i Jashtëm, se ai nuk është shkarkuar nga trysnia e protestuesve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Prej grupeve parlamentare më nuk ka, shkojmë pa grup parlamentar. Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Pas krejt këtyre ndodhive që janë duke ndodhur, Jabllanoviqit, të migrimit, edhe një çështje që po kalohet në heshtje, që po mundohet edhe në fjalimin e kaluar e kisha, është

për çështjen e fëmijëve të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Është kjo kategori, e cila po kalohet në heshtje nga ne deputetët. Nëse jemi korruptuar rastësisht me ndonjë diplomë nga soji i rektorit, që sot e menaxhon Universitetin, nuk do të thotë që veteranët të keqpërdoren. Ata ishte dashur me konformizëm të pranohen dhe t'u jepet mundësia për edukim, por jo të ikin bashkë me këtë emigrimin ilegal sot që po bëhet.

Rektori duhet të shihet sa minoritarë i ka regjistruar dhe sa veta ka spekuluar me atë listë. Ai i quan profesorët e Fakultetit të Mjekësisë, thotë: “janë psikopatë dhe nuk bëjnë asnjë punë” dhe thotë dua të rri rektor. Një rektor i tillë nuk meriton, as nga Këshilli i Përgjithshëm i Universitetit, po as nga themeluesi, që është Kuvendi i Republikës së Kosovës, i Universitetit, të qëndrojë rektor. Ai mund ta turpërojë dhe sjellja e tij stimulon dy çështje: avancimin e universiteteve private; hapjen e rrënimin e Universitetit shtetëror dhe në mënyrë indirekte ndihmon edhe lëvizjen ilegale të popullatës.

Prandaj, një rektor i tillë nuk meriton të qëndrojë. Ata që e përkrahin, disa komandantë, disa politikanë, që sillen te dyert e Qeverisë, ose të ministrave, do ta bartin turpin, sepse me votat e veteranëve shumica nga ne kemi ardhur këtu, jemi ulur.

KRYETARI: Arben Gashi e ka fjalën, vetëm se jemi para përfundimit të kohës.

ARBEN GASHI: Në emër të Grupit Parlamentar. Faleminderit!
Unë kam disa kërkesa për ju, kryetar i Kuvendit.

Kërkesa e parë ka të bëjë me muralet e Kuvendit, që ka më shumë se 14 vjet që janë të mbuluara dhe kërkoj nga ju që t'i trajtoni, mundësisht t'i zbuloni.

E dyta ka të bëjë me fotografinë mortore të presidentit Rugova, që është në hyrje të sallës së Kuvendit dhe mendoj që është një fotografi e padinjitetshme dhe të trajtohet me kujdes dhe, ndoshta njëra nga këto murale mund të jetë fotografia e presidentit Rugova, një punim artistik, i cili do të mund ta zëvendësonte shumë mirë muralin e mbuluar.

Dhe, e treta ka të bëjë me gjuhën parlamentare e cila përdoret. Shumë nga ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, po edhe deputetë, në prononcimet publike, por mund ndodh edhe në sallë të Kuvendit, përdorin termin për Kosovën: “Kosova dhe Metohija”. Është term antikushtetues dhe në rast se ndodh brenda sallës së Kuvendit, kërkoj nga ju që t'ia ndërprisni të drejtën e fjalës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Luljeta Veselaj-Gutaj e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Përsëritet, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Padyshim se rrugëtimi historik i shtetësisë së Kosovës ka kaluar nëpër etapa të rënda dhe sfiduese për popullin e Kosovës. Pa i paragjykuar aspak këta bashkëqytetarë, që ndoshta realiteti i vrazhdë i ka bërë të largohen diku gjetkë, pa e ditur se ku po shkojnë dhe me plotë rreziqe për ta dhe për familjet e tyre, mendoj se ky migrim ilegal nuk është zgjidhje

dhe se këta bashkëqytetarë po bien viktimë të grupeve dhe rrjeteve kriminele, rajonale dhe ndërkombëtare, të cilat organizohen përmes premtimeve të rreme të trafikantëve, duke marrë kështu një rrugë drejt një destinacioni të panjohur dhe të rrezikshëm e që, padyshim se këto grupe trafikantësh, kontrabandimin e shtetasve kosovarë e bëjnë me qëllim të përfitimeve të tyre materiale.

Këto, por dhe shumë zhvillime të tjera të fundit, kanë ndikuar dhe po ndikojnë për të krijuar një gjendje pasigurie dhe frike tek qytetarët e Kosovës, duke i sjell ata në një gjendje të pashpresë, sa që njerëzit e shohin si të pamundur ndërtimin e një jete të mirë në vendin e tyre.

Padyshim, që kohëve të fundit, kontrabandimi i shtetasve kosovarë është një dukuri shqetësuese dhe sikur i konvenoi dikujt dhe atë, qoftë me qëllim të shpopullimit apo largimit të rinisë nga vendi e në të njëjtën kohë edhe për ta dëmtuar imazhin e Kosovës, si një vend shumë i sigurt. Secili qytetar i Kosovës ka të drejtë të kërkojë dhe të gjejë një jetë më të mirë kudo, por jo në formën e migrimit të parregullt.

Ky fenomen, padyshim që do të ketë për pasojë edhe ndikimin në procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët kosovarë, për të cilin proces tash e sa kohë është punuar dhe po punohet me shumë përkushtim. Është e çuditshme, se si në të njëjtën kohë ne po ballafaqohemi me dy situata krejt ndryshe, në njërën anë, si tregohet se në Kosovë po krijohet një stabilitet dhe perspektivë për të gjithë, institucionet e Kosovës tash e sa kohë kanë nënshkruar marrëveshje për kthim dhe riintegrim të qytetarëve të Kosovës, të cilëve u është refuzuar qëndrimi në shtetet evropiane, ndërsa në anën tjetër, sikur këto migrime ilegale, në të cilën shihen: gra, fëmijë, burra dhe të rinj, të cilët mbushin autobusë dhe marrin rrugën drejt të panjohurës, sikur tentojnë të tregojnë krejt të kundërtën.

Andaj, këto problematika duhet që me urgjencë të adresohen dhe të trajtohen sa më parë nga institucionet e Kosovës, duke ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura, por në të njëjtën kohë duke krijuar mundësi që migrimi jashtë vendit të bëhet përmes formave të ndryshme...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! I kemi dy mundësi. Kemi kaluar jashtë 60 minutave, ose në mbledhjen e ardhshme janë të parët, ose mund të krijojmë edhe një mundësi nga një minutë, shpejt. Nga një minutë ju lutem, se janë shumë, janë edhe njëmbëdhjetë veta. Nga një minutë. Atëherë, vazhdojmë nga një minutë. A e mbajmë rendin në bazë të partive, se kemi shkuar me parti. Le të vazhdojë “Vetëvendosje” Ismajl Kurteshi, pastaj do të shkojmë me rend, të gjithë nga një minutë.

ISMAJL KURTESHI: Bile, kërkesa ime është të ma bësh 4 minuta, po nejse, edhe me tre po pajtohem.

Më 16 janar, kryeministri, në konferencën për shtyp pati deklaruar: “Trepça” është në territorin e Kosovës dhe pasuritë e saj janë të Republikës së Kosovës.”. Më vonë ai pati

thënë, se për “Trepçën” nuk do të bisedohet me Serbinë në Bruksel dhe nuk ka nevojë për të thënë, që “Trepça” është e jona”.

Por, tërheqja e Ligjit për bërjen e “Trepçës” ndërmarrje publike menjëherë pas kërkesës së 18 janarit të Kryeministrit të Serbisë, që ky ligj të tërhiqet, i demanton këto deklarata të kryeministrit.

Më 19 janar, Isa Mustafa e tërhoqi ligjin që vetë e kishte sjell në Kuvend, të njëjtën ditë u aprovua në Kuvend, me procedurë të përshpejtuar një ligj, i cili “Trepçës” ia vazhdoi agoninë për sundimin e AKP-së edhe për 18 muaj. E ky ligj po i shitet opinionit si ligj, që e shpëtoi “Trepçën”- kurse, më 20 janar Qeveria e solli në Kuvend Projekt-...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Më vjen keq, deputet, ta bëjmë kështu për të gjithë. Janë edhe njëmbëdhjetë veta, ose e lëmë për herën tjetër. Më vjen keq, nuk mundem vetëm për ju. Me respektin më të madh e kisha bërë edhe dhjetë minuta në qoftë se doni, por një minutë, të lutem!

Atëherë, kalojmë... përfundon çështja e tridhjetëminutëshit, diskutimit, dëgjo, më fal, por po dal jashtë gjithë Rregullores dhe pastaj po krijohet nga vetë ju, thua se nuk e njoh Rregulloren. Ju e dini më mirë se unë, ti ke qenë deputet në disa legjislatura, kjo është koha me Rregullore. Pastaj, në qoftë se dëshironi të krijoni nga mirësjellja ime ta thyej unë çdoherë Rregulloren, mua fare nuk më prish punë, por për publikun nuk është e mirë.

Me Rregullore të takon, e kemi kaluar, në mbledhjen e ardhshme. Edhe një minutë të lutem, atëherë, vazhdoni nga dy minuta, në përgjegjësinë time.

ISMAJL KURTESHI: Kurse, më 20 janar Qeveria e solli në Kuvend Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për ndërmarrje publike. Në këtë projektligj, në nenin 11 të ligjit bazik është shtuar paragrafi 11. 3, ku thuhet: regjistrimi si ndërmarrje publike bëhet në marrëveshje me komunat në territorin, në të cilin gjenden ato ndërmarrje.

Ky paragraf e bënë Serbinë hisedarë në pasurinë kombëtare të Kosovës, përmes komunave veriore, që kontrollohen kryekëput nga Beogradi.

Nëse, ky paragraf aprovohet, atëherë për “Trepçën” nuk do të ketë nevojë të bisedohet në Bruksel, po do të bisedohet në Leposaviq. Edhe veriu i Kosovës është në Kosovë, por 12 mijë shqiptarëve të dëbuar nga veriu, që nga viti 2001 nuk po u lejohet kthimi në shtëpitë e tyre. Edhe Shtërpca është në Kosovë, zoti kryeministër, por kryetari...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kërkoj falje, po më vjen shumë keq, por të lutem nuk do të jetë seanca e fundit, keni shumë kohë për t’i treguar edhe shqetësimet me të drejtë, por vetëm respektojeni pak diçka të krijojmë bashkërisht.

Kërkoj shumë falje, po më vjen shumë keq, është hera e parë që kam ndërhyrë në këtë formë, kërkoj shumë falje.

Vazhdojmë nga 2 minuta. Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

Po mundohem shumë shkurt për t'u treguar kësaj keqqeverisje Mustafa-Thaçi, e cila po e degradon vendin dhe po luan edhe me ndjenjat e qytetarëve me gjendje të rëndë ekonomike.

Vazhdimësia e keqqeverisjes gjatë viteve të fundit dhe mungesa e investimeve të huaja, moskrijimi i vendeve të punës ka bërë që gjendja sociale në Kosovë të jetë shumë e rëndë, në këtë mënyrë vendi po përballlet me një krizë enorme sociale me pasoja gati të paparashikueshme.

Familjet me asistencë sociale, në mungesë të ndonjë vendi të punës dhe kushteve të vështira me të cilat po jetojnë, vazhdojnë të përballen edhe me luftën për mbijetesë.

Kjo keqqeverisje vetëm në muajin shtator - nëntor, vetëm në këtë periudhë ka hequr nga skemat, pra 3 000 familje, këto 3 000 familje jo që u pasuruan, jo që u punësua ndonjë anëtar i familjes së tyre, por u hiqen nga skemat për të paguar buxhetin e kësaj keqqeverisje për numrin e mbi 50 zëvendësministrave të Qeverisë Thaçi-Mustafa, zëvendësministra të cilët nuk po bëhen emrat e tyre publikë për të ikur nga vëmendja e qytetarëve, por çdo ditë po dalin me 2 apo 3 emra.

Pra, edhe një herë, këto familje me asistencë sociale u hoqën nga skemat për t'i paguar këta zëvendësministra dhe numrin shumë të madh të ministrive pra që ka kjo Qeveri që e degradoi vendin.

Pra, edhe një herë, familjarët dhe këto familje nuk kanë nevojë për lot krokodili as sot në Kuvend nga deputetët e PDK-së dhe LDK-së, por për shtytje për të marrë hapa konkret dhe për ndryshuar gjendjen në vend dhe ikjet e fundit që po ndodhin pra janë krejt pasojë e kësaj keqqeverisje dhe iritimit të vazhdueshëm që po i bëhet pra jo vetëm këtyre familjeve, por rinisë tonë të mrekullueshme të cilën ne vetë e reklamuaam gjatë gjithë kohës, por në vend e reklamuaam për të na marrë vendet e tjera...

KRYETARI: Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Unë do të ngre një çështje shqetësuese në mesin e shumë problemeve që ka qytetari i Kosovës. Fjala është për energjinë elektrike, çmimet tepër të larta që faktikisht qytetarët i vënë në një presion.

Mua më vjen keq që ka pasur shumë reagime nga qytetarët, reagime të arsyeshme në këtë drejtim dhe askush nuk është lodhur për t' u marrë me ato shqetësime dhe kjo krijon përshtypjen se në Kosovë shqetësimet e qytetarëve mund të trajtohen vetëm atëherë kur dikujt i rrezikohet karrigia, siç ndodhi me protestat e fundit.

Unë mendoj se krijimi i kësaj logjike për probleme të caktuara që kanë qytetarët është i gabuar, sepse dëmton thellë imazhin e Kosovës, por edhe dëmton thellë demokracinë.

Në fund të fundit, institucionet, veçanërisht Qeveria është për t'u marrë me halle dhe problemet e qytetarëve dhe energjia elektrike është një nga shqetësimet e vazhdueshme në Kosovë jo vetëm për çmimin e lartë që është më i larti në Evropë, një vend më i varfër me çmim më të lartë të energjisë elektrike në Evropë, është një diskrepancë e mbijetesës dhe mirëqenies së qytetarëve në një vend.

Në këtë drejtim ndalimi i rrymës pa kurrfarë kriterie thjeshtë shpesh krijohen skena të jetës si në mesjetë dhe t'ju thënë të drejtën në këtë drejtim unë mbrëmë desha të merrem të krijoj një koncept, mirëpo me qiri nuk u krijuaka ai koncept për këtë fenomen trishtues që po ndodh për vite të tëra.

T'ju them të drejtën Kosova, siç e dini ju, është një lagje e Berlinit apo një lagje e Stambollit. Është më shumë se një turp që 15 vjet të mos mund ta rregullojë çështjen e energjisë...

KRYETARI: Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim Sayın Başkan. Değerli Bakanlar ve Milletvekilleri Bilindiği üzere Meclis kanun yapar ve ülkenin demokratikleşmesiyle birlikte Avrupa standartlarıyla uygun hale gelmesi için halkın tamamının haklarını koruma altına alır. Biz vekiller toplumumuzun tümünün çıkarlarını korumak ve bu kanunlarla ilgili garanti altına almakla görevliyiz. Halktan aldığımız destek bunun içindir. Meclisimizin yasa ile kurduğu RTK yani Kosova Radyo-Televizyonu bugün bu konuşmam sırasında bile görevini yine eksik olarak yerine getirmekte ve konuşmamı Arnavutçaya tercüme etmemektedir.

Benim asıl dikkat çekmek istediğim husus yine RTK çalışmalarıdır. Daha doğrusu Meclisimizin kurduğu ve bir kamu kuruluşu olan RTK-dan Türk toplumunun yasal hakkının ihlal edilmesidir. Mecliste oylanan 04046 RTK Yasasının 8. maddesinde RTK-nın iki televizyon kanalını içerdiği belirtilmekte ve bu kanalların her ikisinde de zaman diliminin yüzde 15-nin diğer toplulukların dillerinde yayın yapmak için ayırmasını zorunlu hale getirmektedir. RTK birde yasanın bu maddesine kısmen olursa da RTK ikide maalesef bir dakika bile Türk dilinde yayına rastlamak mümkün değildir. Bu tam anlamıyla bir kanun ihlalidir.

RTK müdürü ve bordu üyeleri bu durumu bilmelerine rağmen ne yazık ki yasaı ihlal etmeye devam etmektedirler. RTK-nın 2015 yılı planlamasında bile yasanın bu maddesine uygun hareket etme niyeti yoktur.

KRYETARI: Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit kryetar!

Janë raportet më të reja të Fondit për të Drejtën Humanitare, të cilat shefin e shtetit e Shtabit të Përgjithshëm, Lubisha Diković e kanë bërë përgjegjës për krimet e kryera në fshatin Rezallë dhe në Çikatovë të Vjetër.

Ndonëse ky i fundit e ka pasur për obligim që t'i parandalojë krimet e rënda kundër civilëve, Diković bashë me njësitet është dëshmuar si përgjegjës për këto krime dhe për fshehjen e trupave për 15 vjet në varrezën masive në Rudnicë.

Njësitet e tij kanë qenë në Izbicë ku kanë vra mbi 100 persona e po ashtu edhe në fshatin Çirez, po këto njësi kanë kryer krimet më brutale ndaj 25 djemve të moshës jomadhore, trupat e të cilëve nuk janë gjetur ende.

Dhe, përkundër gjuhës së argumenteve dhe fakteve të ofruara nga Fondi për të Drejtën Humanitare, Qeveria e Serbisë ende po heziton t'i dënojë përgjegjësit dhe të kërkojë falje për krimet. Gjuha e përdorur nga Beogradi po dëshmon se një hap drejt së vërtetës është shumë i vështirë për t'u arritur edhe atëherë kur argumentet thonë se civilët në Skenderaj dhe Drenas u vranë dhe u zhdukën në prani të Brigadës 37 dhe se ushtarët e kësaj brigade janë përgjegjës për vrasjen e mbi 400 civilëve.

Zbardhja e krimeve të kryera në Kosovë, por edhe pranimi i asaj që ka ndodhur, është ndër çështjet më të rëndësishme për të ardhmen e vendit, por edhe për normalizimin e raporteve ndërmjet dy shteteve.

Është mënyrë e vetme për të pajtuar shoqërinë, prandaj si deputete e këtij Parlamenti, por edhe si bashkëfamiljare e atyre që ende presin kthimin e trupave në Rezallë, kërkoj nga institucionet e Kosovës që t'i nisin hetimet lidhur me rastin Diković dhe apeloj që të shfrytëzohen të gjitha rrugët ligjore që përgjegjësit që kanë kryer krime në Kosovë të dalin para drejtësisë dhe në asnjë mënyrë të mos shpërblehen me poste të rëndësishme shtetërore. Faleminderit!

KRYETARI: Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Dje janë mbushur 15 vjet nga masakra ndaj shqiptarëve që jetonin në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, më saktësisht në natën mes 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000, në veriun e Mitrovicës u ekzekutuan 10 qytetarë shqiptarë, kryesisht fëmijë, gra dhe pleq të familjeve Ajeti, Xhaka, Canhasi, Berisha, Voca, Rrukeci, Sejdiu, Abrashi dhe Sokoli.

Në të njëjtën natë u plagosën rëndë dhe u keqtrajtuan fizikisht edhe dhjetëra të tjerë dhe është një prej netëve më të rënda të spastrimit etnik të veriut të Kosovës nga qytetarët shqiptarë.

Vetëm atë natë u dëbuan rreth 100 familje, kryesisht po e përsëris, fëmijë, gra dhe pleq dhe gjatë muajit shkurt të vitit 2000 janë dëbuar afërsisht 2000 familje që bëjnë rreth 12 000 shqiptarë të dëbuar nga kjo pjesë.

Dëbimi, natyrisht, ka vazhduar vite me radhë dhe fatkeqësisht edhe sot e kemi një situatë ku qytetarët shqiptarë lëre që nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre, por edhe ata të paktë që e marrin guximin ta mbrojnë pronën e tyre dhe t'i rindërtojnë shtëpitë në Kroin e Vitakut, nuk po lejohen ta bëjnë një gjë të tillë.

Fatkeqësisht, drejtësia për këto familje është vonuar më shumë se 15 vjet dhe tani e kemi një person zyrtar që ka qenë edhe pjesë e institucioneve të Kosovës që po akuzohet dhe po gjykohet për këto krime të kryera në vitin 2000.

Në një situatë të tillë, përveç problemeve ekonomike dhe të varfërisë, përveç mungesës së mirëqenies sociale, është natyrisht edhe mungesa e drejtësisë dhe mungesa e barazisë para ligjit e cila po i shtynë qytetarët e Kosovës të marrin rrugën e tmerrshme dhe të rrezikshme të migrimit ilegal për të cilën u fol aq shumë.

Fatkeqësisht, po këta qytetarë që u dëbuan nga veriu i Mitrovicës, tashmë po kthehen në veri, mirëpo për të hyrë nëpër autobusët e veriut të Mitrovicës dhe për t'u larguar nëpërmjet Serbisë, për t'u larguar nga vendi i tyre, siç e thashë sepse nuk e kanë parë jo vetëm perspektivën...

KRYETARI: Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do flas shumë shkurt. Dua ta adresoj një çështje për të cilën më janë drejtuar disa nga qytetarët e disa fshatrave të Mitrovicës që është në fakt shumë e rëndësishme dhe jetësore për ta, lidhet me prodhimin e patates, që në fakt u kanë mbetur pa u shitur për shkak të bllokadave të ndryshme ekonomike me të cilat ato përballen.

Unë në fakt dua t'i drejtohem ministres së Tregtisë, sepse shqetësimi i tyre është pse është e pamundur që për derisa ekziston tregu në Turqi, nuk respektohet ajo marrëveshje për tregti të lirë me këtë shtet, ku janë problemet në lidhje me këtë marrëveshje, a duhet që Turqia... kjo marrëveshje të zbatohet vetëm në mënyrë të njëanshme, domethënë prodhimet turke të vijnë në Kosovë, ndërsa ne nuk do të mund t'i dërgojmë ato prodhime atje.

Kërkoj një përgjigje nga Ministria dhe ndoshta është mirë që të bashkëpunojmë me këto grupe të cilat në fakt do të kanë ndërmend të trokasin në derën e Ministrisë së Tregtisë për të parë se si mund të zgjidhet ky problem. Në fakt këta njerëz janë jashtëzakonisht të shqetësuar, sepse i gjithë prodhimi i tyre i cili u ka kushtuar atyre, por i ka kushtuar edhe shtetit me subvencione, do t'iu shkojë poshtë, patatet do të kalben dhe do t'u mbeten pa u shitur, sepse për momentin janë tërësisht nën koston e prodhimit, çmimi i tregut.

Ky është shqetësimi që desha ta adresoj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja deputete, jo për të mësuar, por do të ishte mirë të ishte pyetje parlamentare dhe të vazhdojë si shqetësim për Ministrinë e Tregtisë. Atëherë, Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Dje, më 4 shkurt është shënuar Dita botërore e luftës kundër kancerit, apo dita kundër kancerit. Në këtë ditë Organizata Botërore e Shëndetësisë publikon rekomandime mbi mënyrën se si mund të parandalohet dhe luftohet kjo patologji.

Dita Botërore Kundër Kancerit, Ministrinë e Shëndetësisë e ka gjetur citostatikë, ilaçe të nevojshme e të domosdoshme për të luftuar sëmundjen e kancerit.

Mungesa e citostatikëve dhe barnave nga lista esenciale është evidente që disa muaj, dukuri që është bartur nga viti në vit, por muajve të fundit institucionet shëndetësore publike janë futur në një krizë të thellë në aspektin e furnizimeve me barna nga lista esenciale në veçanti të furnizimit me cistostatikë, e që për qytetarët e vendit e ka krijuar një problem dhe shqetësim të madh.

Viteve paraprake ky furnizim ishte i pjesshëm, asnjëherë 100%, ndërsa tani kur kemi bërë alamet reforma, kemi hyrë në muajin e dytë të vitit 2015, kemi mungesë totale të furnizimit me cistostatikë dhe barna tjera nga lista esenciale.

Kjo gjendje ka shkaktuar pakënaqësi te pacientët e sëmurë me kancer, që i nënshtrohen kimioterapisë, disa nga ata që kanë mundësi barnat po i blejnë vetë, ndërsa të tjerët janë detyruar të prishin në rendin e protokollit dhe trajtimet me cistostatikë si pasojë e pamundësisë financiare për të siguruar këtë terapi të shtrenjtë.

Problemi i krijuar i mosfurnizimit me cistostatikë nuk është i buxhetit për shëndetësi, sepse ai nga viti në vit është rritur, por kjo gjendje është shkaktuar si pasojë e reformave që kanë ndodhur në Ministrinë e Shëndetësisë, të ashtuquajturave reforma, kjo ka bërë që procedurat me furnizim me barna nga lista esenciale dhe cistostatikë të vonohet nga Ministria e Shëndetësisë, e cila e ka përfunduar një planifikim të tillë në vitin 2013, por që nuk është zbatuar e as respektuar nga vetë ata që e kanë miratuar këtë planifikim.

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka rekomanduar për shtete të cilat nuk kanë mundësi buxhetore që t'i përmbushin nevojat për shëndetësi, të aplikojnë masat restriktive, por me bazë shkencore duke caktuar prioritetet e furnizimit në bazë të analizës 'ven', apo analizës esenciale...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Haxhi Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Fjalimin tim do ta përqendroj te protestat e fundit. Pa dyshim se ne si "Nismë" jemi kundër protestave të dhunshme dhe njëkohësisht jemi edhe kundër ndërhyrjes së

dhunshme të Policisë së Kosovës kundër qytetarëve tanë. Që ta trajtoj këtë temë më së shumti më shqetësoi qëndrimi i raportit të ministrit të Brendshëm dhe drejtorit të Policisë së Kosovës, pasi sipas përgjigjeve të tyre në pyetjet e deputetëve lidhur me atë se kush dha urdhër për ndërhyrje kundër protestuesve, kjo pyetje e deputetëve nuk mori asnjë përgjigje nga këta dy, të cilët janë përgjegjës për rendin dhe sigurinë e vendit dhe na japin llogari për dhunën, e cila ushtrohet nga të dyja palët.

Ju jeni ministër për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe jeni përgjegjës për mbajtjen e rendit dhe sigurinë e vendit. Ju nuk jeni vetëm ministër që ta komandoni Policinë, por jeni përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe sigurisë, duke përfshirë edhe qytetarët e Kosovës.

Me këtë dua të ju themi se Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për të gjitha dëmet e shkaktuara nga protestat e fundit.

Zoti ministër, në raportin tuaj keni theksuar se ju nuk keni dhënë urdhër për ndërhyrje. Është e vërtetë që nuk ju takon juve të urdhëroni, por ju jeni ministër i Rendit dhe ju ka takuar që t'ia jepni një urdhër drejtorit të Policisë që të mos ushtrohet dhunë ndaj protestuesve, apo ndjekja e tyre nga Policia nëpër rrugët e kryeqytetit, pamje ato që ngjajnë me kohën e sundimit të Milosheviqit, ose më mirë të themi si Ukraina e ditëve të sotme.

Zoti ministër,

Kërkoj nga ju që t'i hapni hetimet për disa policë apo komandues të Policisë, të cilët kanë ushtuar dhunë jashtë kompetencave të Policisë ndaj qytetarëve të Kosovës.

Kjo thirrje imja është dhe shkon në shërbim të ruajtjes së imazhit të Policisë së Kosovës, kur atë ditë në protesta e dyta disa policë i kanë shkelur rregullat e Policisë së Kosovës.

Qytetarët e Kosovës duhet ta kuptojnë se askush nuk është mbi ligjin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Edhe pse nga ne të gjithë tashmë është theksuar dhe përsëritur disa herë se protesta është mjet demokratik për shfaqjen e pakënaqësisë qytetare, se protesta është e drejtë themelore e njeriut në një sistem demokratik dhe një element thelbësor i një sistemi të tillë shtetëror, megjithatë duhet po ashtu të theksohet se protestat e fundit në Prishtinë mund t'i quajmë me vetëm një emër: tentim për rrëzimin e Qeverisë dhe marrjen e pushtetit nëpërmjet metodave të dhunshme.

Një ministër serb, i cili me injorancën e tij e bëri një deklaratë jashtëzakonisht fyese, duke e shoqëruar me një tentim arrogant për ndryshimin e fakteve historike, që për çdo mendje të shëndoshë ishte po ashtu një ofendim shtesë, ishte pretekst, por jo qëllim i protestave, të cilat i tronditën qytetarët e këtij vendi.

Edhe çështja e tretë që s'u mor si pretekst, por kjo çështje më së paku mund të zgjidhet duke gjuajtur gurë mbi ndërtesën e Qeverisë, duke i shkatërruar sheshet, duke i shkatërruar pronat private, duke lënduar qytetarë dhe duke zbrazur mllefin mbi çdo gjë që u del përpara, e asnjëherë duke mos e thënë të vërtetën dhe realitetin për "Trepçën".

Pra, organizatorët e kësaj proteste, duke ndezur mllefin me një vokabular jashtëzakonisht propagandues, as edhe një minutë të vetme nuk u trembën se në ato protesta mund të vinte deri te humbja e jetës, e cila për fat të mirë nuk ndodhi, por në çdo moment edhe mund të ndodhte.

Duke e pasur të qartë qëllimin e tyre, organizatorët e këtyre protestave në asnjë moment nuk u treguan të gatshëm ta marrin përgjegjësinë që u takon. Përkundrazi, ata vazhdojnë me fjalorin e tyre fashist, duke u distancuar nga vetë votuesit e tyre, të cilët u shfrytëzuan për të ushtruar dhunë, e deri në vjelljen e mllef, duke e drejtuar gishtin kundër forcave të Rendit të Republikës së Kosovës.

Policia e Republikës së Kosovës e ka menaxhuar situatën në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne të gjithë jemi dëshmitarë për ultimatumin dhe kërcënimet që iu bënë Policisë së vendit tonë dhe po ashtu jemi dëshmitarë që në këto protesta kishim më shumë policë të lënduar se sa demonstrues. Ky është një tregues që Policia e Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Atëherë, pasi është profesor Universiteti, Shpejtim Bulliqi edhe një herë dhe ta përfundojmë.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryetar!

Të respektuar deputetë,

Ju përshëndes të gjithëve,

Unë u nxita ta marr këtë fjalë nga fakti që para disa netëve në mjetet e informimit publik doli një informacion lidhur me tenderimin e kompanisë, e cila planifikohet ta bëjë ndërtimin e Termoelektranës së Re të Kosovës.

Qytetarët e Kosovës janë dëshmitarë të faktit që për më tepër se 10 vjet ka filluar puna rreth ndërtimit të kësaj termoelektrane, varësisht nga qeveritë e ndryshme të cilat janë ndërruar për këtë periudhë kohore, dikush me Termoelektranën e Kosovës C, e dikush me Termoelektranat e Kosovës të Re, e tash së fundi nga të gjitha kompanitë, të cilat faktikisht kanë tenderuar në këtë tender. po flitet që ka mbetur vetëm një kompani, për të cilën po i them disa informacione që dolën nga disa OJQ, meqë me manipulime të ndryshme rreth këtij tenderi janë përfshirë edhe disa emra të ish-ministrave të mëhershëm.

Dhe, po më intereson që ndoshta në një moment të caktuar dikush nga Qeveria, nga ministrat përkatës, të na japë një informacion lidhur me ecurinë e tenderimit të ndërtimit të Termoelektranës së Re dhe në të kemi pak a shumë si parlamentarë informacione rreth procedurave të ecurisë se deri në çfarë mase deri në çfarë shkalle ka shkuar kjo ecuri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, konstatoj se me insistimin tuaj dhe me dëshirën time e kemi thyer Rregulloren, e përgjegjësia është imja.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj që me kërkesë të kryetarit të Kuvendit, e me vendim të Presidentes së Republikës së Kosovës, është bërë zëvendësimi i deputetit zotit Jakup Krasniqi, pas dorëheqjes së tij, me deputetin zotin Enver Hoti, nga subjekti politik “Nisma për Kosovën”.

Deputetit të ri i dëshirojmë mirëseardhje dhe punë të mbarë në Kuvend. E kisha lutë deputetin Enver Hoti, pasi e ka tekstin e deklaratës së betimit para vetes, ta nënshkruaj personalisht betimin dhe të na e sjellë në Administratë, pasi ai edhe kështu është i betuar. Faleminderit!

2. Koha për pyetje parlamentare

I kemi 18 pyetje parlamentare. Pyetja në maksimum zgjat dy minuta, ndërsa përgjigja deri në tre minuta.

Pyetja e parë, i nderuar deputet Ismajl Kurteshi, ministrin nuk e kemi aktualisht, dëshironi ta bëni pyetjen?

ISMAJL KURTESHI: Do ta lexoj pyetjen për zëvendëskryeministrin, meqë ai si duket i ka dy vende të punës, të parën e ka në Beograd të Vuçiqi, e këtu kur po i del kohë nganjëherë po vjen. Pyetjen e kam shkruar më 15 dhjetor dhe ka qenë kjo:

Ju zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, që nga 9 dhjetori i vitit 2014, dëshiroj të më njoftoni a e njihni pavarësinë e Republikës së Kosovës? Mirëpo, ky zëvendëskryeministër me veprimet e tij ma ka dhënë përgjigjen, kështu që përgjigje tjetër prej tij nuk pres, por pres reagim të Qeverisë ndaj atyre të cilët po i shfrytëzojnë nga dy vende të punës dhe kryeministër të vërtetë e kanë Vuçiqin, e jo Isa Mustafën, i cili po tregohet jashtëzakonisht shumë tolerant ndaj këtyre ministrave dhe ndaj veprimeve të tij.

I njëjti njeri, para disa ditësh në Graçanicë, kur e ka zbuluar përmendoren e Kral Milutinit, ka thënë se kjo është përmendorja e parë e tij në Serbi, që do të thotë se për të Kosova është Serbi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Duke pasur parasysh se është hera e dytë - pyetje për zëvendëskryeministrin, e nuk ka marrë përgjigje, ta dini se të gjitha këto do të publikohen në revistën e Kuvendit që nuk

marrin përgjigje. Kjo është ajo. Domethënë, e përfunduar me dy pyetje, edhe pyetjen e parë për ministrin Jablanoviq, edhe për zëvendëskryeministrin. Ok-ej.

ISMAJL KURTESHI: Me Jablanoviqin s'e kam mendjen, me Jablanoviqin unë më nuk do të merrem, janë marrë qytetarët e Kosovës, ia kanë treguar ku e ka vendin, edhe krejt është në rregull, është mirë t'u tregohet vendi edhe tjerëve, të cilët e meritojnë këtë.

KRYETARI: Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Haki Demolli.

DAUT HARADINAJ: Meqenëse ministri nuk është këtu, atëherë unë mendoj që edhe pyetjen ta tërheq. Gjithsesi e shpjegoj që pyetja ka qenë kur do të vijë pakojë ligjore për transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosura?

Por, po ashtu, kryetar, më lejo shumë shkurt, për 10 sekonda, nga një koleg deputet që më parë liderët e opozitës u quajtën fashistë. Do të thotë që jeni të detyruar t'i ndërpritni fjalën, sepse kjo është fyerje.

KRYETARI: Mirë, do të ishte të ruheni për njëri-tjetrin, por secili e bart përgjegjësinë morale para opinionit për atë çfarë flet këtu.

Deputeti Daut Haradinaj, po ashtu pyetje për ministrin Skender Hyseni.

DAUT HARADINAJ: Ka qenë pyetje në seancën e kaluar rreth gjendjes së zjarrfikësve. Gjithsesi, ministri edhe në komision është deklaruar që do ta japë përgjigjen me shkrim, kështu që unë e konsideroj që ka përfunduar kjo temë.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Pasi në seancën e fundit nuk ishte i informuar, i mungonin shënime statistikore, të cilat do t'i kishte siguruar në bazë të sistemit të informimit shëndetësor sipas Ligjit të shëndetësisë, në Qendrën Klinike Universitare nga viti 2007 deri në vitin 2011 janë kryer 200 koronografi dhe katër stendime, ndërsa prej se Kardiologjia invazive është udhëhequr nga doktor Sami Gjoka, prej vitit 2011 deri në vitin 2014 janë kryer 2681 koronografi dhe 351 stendime.

Kjo punë është kryer me shumë vështirësi dhe pengesa nga Ministria e Shëndetësisë, e cila nuk ka bërë furnizime të duhura, prandaj, i nderuar ministër, para disa ditësh, me inicimin e drejtorit të Kardiologjisë, SHSKUK ka ndëshkuar me masë disiplinore para përjashtim doktor Sami Gjokën, për shkak se ky folur në media për punën e cila është bërë në Kardiologjinë invazive dhe pengesat që ka pasur në furnizimin me material përkatës për t'i kryer ndërhyrjet e duhura, mbi 3000 sosh brenda katër vjetëve, që është me mijëra herë në raport me katër vjetët paraprake.

Pyetja është: A është kjo politikë e Ministrisë së Shëndetësisë, apo e SHSKUK-së që të ndëshkohen doktorët punëtorë të ndërgjegjshëm në sektorin publik, të cilët nuk i ndalin allishverishet me sektorin privat për referime të pacientëve, ndërsa favorizohen doktorët, të cilët për një kujdestari kanë referuar deri në 13 pacientë në sektorin privat. Pyes: Cili është qëllimi i kësaj censure? Prej kur doktorëve u ndalohet të flasin për profesionin e tyre? Sa mjete janë investuar në Kardiologji dhe në Kardiokirurgji prej hapjes së saj dhe sa pacientë janë trajtuar me mjetet e buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë në sektorin privat? Sa pejsmekerë janë vendosur në Klinikën e Kardiologjisë dhe pse në vazhdimësi po bllokohet furnizimi i tyre në sektorin publik, ndërsa pacientët po referohen në sektorin privat? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I nderuar ministër, urdhëro!

IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë ministra,

I nderuar deputet Haxhiu,

Në seancën e kaluar ju thashë se nuk i kam shënimet complete të kërkesave tuaja lidhur me statistikën në shërbimet e Kardiologjisë dhe Kardiokirurgjisë.

Ju them që edhe Kardiologjia invazive, edhe Kardiokirurgjia janë nga prioritetet e Kabinetit qeveritar, që janë një vazhdimësi edhe e prioritetëve të mëhershme dhe se nuk është intenca as e ministrisë, por as e menaxhmentit të shërbimit spitalor, që të ndëshkohet askush, por është tendenca dhe qëllimi që të vendoset rregulli dhe rendi dhe aty të merren shërbime cilësore për qytetarët e Kosovës.

Unë ju them që në Kardiokirurgji janë bërë rreth 60 operacione, diku 84 operacione janë bërë jashtë institucioneve publike me një kosto rreth 500 mijë euro, dhe se jemi në fazën e konsolidimit, respektivisht të funksionalizimit të Kardiokirurgjisë me partnerët tanë nga Shqipëria, Italia dhe të tjerë, dhe shumë shpejt do të dalim me rezultate konkrete.

Klinika e Kardiologjisë që në vitin 2011 ka bërë 635 koronografi, por për shkak të kohës ju them që në vitin 2014 ka mbërrirë në 962. Në vitin 2011 janë bërë 25 stendime, kurse në vitin 2014, 249.

Ndërsa, deri në tetor të vitit të kaluar nuk është bërë asnjë pejsmeker, në tetor janë bërë 8, kurse në fund të dhjetorit 34. Këto janë shënimet të cilat besoj që e japin përgjigjen për gjendjen në Kardiokirurgji dhe Kardiologji, pa hyrë në komentimet rreth veprimeve eventuale që janë bërë kundër individëve. Atje janë organet kompetente, të cilat do të raportojnë dhe sigurisht që ne do të marrim masa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! I nderuar deputet Bekim Haxhiu, ke pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar ministër!

Unë nuk ju fajësoj për gjendjen, për arsye që po sa e keni marrë detyrën dhe uroj që vërtet Kabineti juaj qeveritar dhe Ministria e Shëndetësisë të jenë të përgjegjshme dhe të kujdesshme që lista e pritjes të mos jetë e gjatë në Kardiologji dhe në Kardiologjinë

invazive, për arsye se ajo ishte shkurtuar në një javë pritje për pacientë, e tani ka kaluar mbi një muaj e gjysmë lista e gjatë e pritjes dhe uroj që me insistimin tuaj furnizimet të cilat i ka Ministria e Shëndetësisë, kontratat t'i respektoj dhe t'i zbatojë dhe pacientët të mos referohen në sektorin privat për kontratat të cilat i posedon Ministria e Shëndetësisë, sepse edhe është shkelje ligjore, edhe është dëm të pacientëve tanë.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Haxhi Shala, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

HAXHI SHALA: Faleminderit kryetar!

Edhe pse kryeministri nuk është këtu, por unë po e bëj pyetjen, besoj që në seancën tjetër...

KRYETARI: Kërkoj falje, kryeministri ia ka deleguar ministrit Hyseni të drejtën për t'u përgjigjur juve. Vazhdoni me pyetjen.

HAXHI SHALA: Jo kryetar, faleminderit! Kjo pyetje për kryeministrin, nuk është kompetencë e tij. E bëjmë në seancën tjetër, kur do të jetë kryeministri i pranishëm.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, e lëmë për seancën e radhës. Prapë deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BEKIM HAXHIU: I nderuar ministër!

Sipas Ligjit të shëndetësisë, neni 15, pika 1, kujdesi shëndetësor organizohet dhe zbatohet në tri nivele. Qytetarët e komunave Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Fushë-Kosovë, Lipjan dhe Drenas nuk kanë se ku ta marrin kujdesin dytësor. Pacientët e këtyre komunave nga kujdesi primar referohen drejtpërdrejt në kujdesin terciar. Tani pas themelimit të SHSKUK-së, as këtë shërbim nuk e marrin në institucionet e lexuara, sepse QKUK-ja tani e disa muaj është shuar së ekzistuari me dokumente.

Shërbimi spitalor dhe klinik universitar i Kosovës, rregullohet me Ligj të shëndetësisë nga neni 62 deri në nenin 69. Sipas Ligjit të shëndetësisë, i miratuar me 13 dhjetor 2012, ekzistimi dhe funksionimi i QKUK është i siguruar me nenet 17, pika 4.1; neni 21 dhe neni 64, pika 3.1. Bazuar në shkresat zyrtar të SHSKUKU, tani disa muaj praktikisht dhe juridikisht është shuar QKUK-ja.

Pyetja është, i nderuar: Në cilin institucion të licencuar nga Ministria e Shëndetësisë qytetarët mund t'i marrin shërbimet e kujdesit tretësor shëndetësor, pasi që institucioni i licencuar QKUK është shuar, ndërsa SHSKUK-ja është organ menaxhues që përbëhet nga sektori dytësor dhe tretësor. Nuk është klinikë, prandaj as nuk ka aplikuar, as që ka licencë për operim si klinikë terciare. Ku mbeti QKUK-ja? Nëse ekziston, atëherë kush është menaxhmenti i saj? Nëse nuk ekziston, kush e ka shuar dhe në bazë të cilit ligj dhe kur pritet që qytetarët e komunave Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Fushë-Kosovë, Lipjan dhe Drenas të kenë të organizuar shërbimin e kujdesit dytësor? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit i nderuari zoti Haxhiu,

Ashtu siç i cituat edhe ju, nenet dhe ligjet, ju them që me Ligjin e shëndetësisë, neni 62 - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, paragrafi 2 dhe 3, neni 63, paragrafi 2, akti themelor i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës është statuti, të cilin e ka miratuar Qeveria e Kosovës me propozim të ministrit të Shëndetësisë më 11 nëntor 2013, dhe me aprovimin e këtij statuti është themeluar Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, me të cilin akt konform Ligjit bazë të shëndetësisë është bërë integrimi i plotë i të gjitha institucioneve të kujdesit shëndetësor, dytësor dhe tretësor, në një organizatë që tash njihet si Shërbim Spitalor Klinik Universitar.

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar drejtohet nga Bordi Drejtues, siç është paraparë me Ligjin për shëndetësi, neni 44, paragrafi 3, dhe me statusin e shërbimit spitalor. Për informatën tuaj, shërbime shëndetësore të nivelit tretësor ofrohen në të njëjtat klinika në të cilat janë ofruar edhe më herët, por tash në kuadër të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar, dhe, natyrisht, për të gjithë banorët e Kosovës, përfshirë edhe banorët e komunave që ju i cekët.

Nëse shqetësimi juaj ka të bëjë më tepër me problemin e referimit të pacientëve nga kujdesi parësor në atë tretësor, atëherë më lejoni t'ju njoftoj se referimi nga kujdesi parësor bëhet në të njëjtën rrugë si më parë, vetëm se tani pacientët referohen drejtpërdrejt për shërbimet përkatëse në klinikat përkatëse, rastet emergjente në emergjencë. Është fjala për komunat, të cilat nuk e kanë shërbimin dytësor të organizuar.

Ndërsa, sa i përket shërbimit të kujdesit shëndetësor dytësor për komunat e cekura dhe për Prishtinën, ju njoftoj se Ministria e Shëndetësisë ka planifikuar ndërtimin e një spitali, por që për shkaqe buxhetore ndërtimi dhe funksionalizmi i tij është shtyrë për disa vite. Ne shpresojmë që me angazhimet tona të përbashkëta do të gjejmë zgjidhje që kjo të bëhet edhe më herët.

I nderuar zoti Haxhiu, integrimi i institucioneve shëndetësore është në kujdesin spitalor klinik universitar dhe në të gjitha nivelet është i paraparë edhe në strategjinë sektoriale të viteve 2015-2020.

KRYETARI: Deputeti, Haxhiu pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, ministër!

Kjo është një letër-qarkore që e ka dërguar drejtori i përgjithshëm i QKUK-së, me të cilën e ndalon përdorimin e logos të QKUK-së dhe favorizon apo sugjeron që të përdoret logoja e SHSKUK-së. Me Ligjin e shëndetësisë funksionimi i QKUK-së është i garantuar me nenin 17 pika 4, prandaj cila është e drejta ligjore të shuhet një institucion i tillë terciar?

KRYETARI: Ministër, të lutem!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit!

T'ju them që Ministria e Shëndetësisë është e interesuar që t'i respektojë ligjet në fuqi dhe të veprojë konform asaj që e mundësojnë ligjet, të cilat ju i keni votuar dhe i ka aprovuar ky Parlament i nderuar. Ne jemi në fazën e reformimit të sistemit shëndetësor dhe në rrugëtim e sipër aty ku do të vërejmë që kemi të bëjmë me probleme të mëdha, të cilat duan edhe ndryshime të ligjit, ne jemi të gatshëm që në bashkëpunim me ju ta amendamentojmë Ligjin për shëndetësi dhe ligjet tjera që e rregullojnë sferën e reformimit të sistemit shëndetësor dhe do të ecim së bashku. Natyrisht që reforma është e dhimbshme dhe ka sfida, por besoj që jemi në rrugë të drejtë, duke iu falënderuar edhe ndihmës së madhe që marrim nga konsulentët dhe partnerët tanë, edhe ndërkombëtarë, edhe vendorë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Deputetja Xhevahire Izmaqu, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër Abrashi,

Fillimisht më lejo ta uroj një punë të mbarë, duke e ditur faktin që do ta kesh një punë goxha të vështirë, me gjithë këtë gjendje sociale, që me të vërtetë është e rëndë, posaçërisht ditëve të fundit, duke i parë të rinjtë tanë që po e marrin rrugën e kurbetit.

Unë e kam një pyetje lidhur me familjet të cilat i kemi me asistencë sociale, mirëpo konkretisht pyetja ime shkon në këtë drejtim: Familjet të cilat janë në asistencë sociale, ndihma u ndalet në momentin kur fëmija i tyre i bënë 5 vjet. Pra, është një kriter i cili e vështirëson këtë gjendje, duke e ditur se nëse një fëmijë mbush 5 vjet, ne e dimë faktin që ai nuk do të arrijë të punojë ose t'i sigurohet një e mirë materiale asaj familjeje. Pra, kriteri është në ligj, mirëpo pyetja për ju është: A e dini sa është numri i këtyre familjeve që po mbeten pa këtë ndihmë sociale me këtë kriter, të cilin sigurisht që në momentin kur do të mund ta amendamentojmë, unë do të propozoj që ta largojmë si kriter. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI ARBAN ABARASHI: I nderuar kryetar!

Ministra,

Deputetë,

Faleminderit për pyetjen, ngase është një prej shqetësimeve të mia që gjithashtu e kam pranuar me emërimin në detyrë. Shkurtimisht do t'i jap disa të dhëna që kanë të bëjnë me këtë kriter. Kriteri ka të bëjë me kategorinë e dytë, ku familja me një anëtar të familjes të aftë për punë, me të paktën me një fëmijë nën moshën 5 vjeç, apo që e kanë përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën 15 vjeçe, anëtari i aftë për punë duhet regjistruar si konkurrues në Zyrën e Punësimit. Domethënë, ky është neni i cili e specifikon këtë kriter.

Sa për informatë, kriteri i fëmijës nën moshën 5 vjeçe për kategorinë e dytë për ndihmë sociale është vetëm njëri nga kriteret e shumta për ndihmë sociale, por jo edhe i vetmi. Ky kriter më tepër ka karakter të një kushtëzimi buxhetor limitues për ndihmën për skemën e ndihmës sociale. Kërkesa dhe shqetësime të tilla janë shtuar edhe më herët dhe ka pasur kërkesa që kjo edhe të tërhiqet tërësisht, përkatësisht është hetuar që në rishikimin dhe ndryshimin e plotësimit të Ligjit të skemës për ndihma sociale në vitin 2012 nga grupet e eksperteve, si dhe në Grupin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, mirëpo nuk kanë kaluar përkatësisht për shkak të implikimeve të mëdha buxhetore.

Sa i përket numrit, numri i familjeve të shfrytëzuesve të ndihmës sociale çdo muaj është i ndryshueshëm, nuk është konstant, që do të thotë çdo muaj hyjnë dhe dalin nga skema, për shkak të ndryshimit të kushteve dhe të kriterëve që i përcakton ligji.

Gjatë vitit 2014, në nivel vendi, në kategorinë e dytë të ndihmave sociale janë ndërprerë gjithsej 2 355 familje, prej tyre 365 familje janë gjetur nga ATK si tatimpagues me të hyra financiare, 531 familje për dy muaj radhazi nuk i kanë tërhequr ndihmat sociale dhe 1 459 familje janë ndërprerë për shkak të kriterëve të kategorisë së dytë, sikur edhe përmirësimi i gjendjes socio-ekonomike, punësimi, emigrimi dhe fëmija mbi moshën 5-vjeçare.

Sipas të dhënave të Ministrisë, aktualisht në dhjetor të vitit 2014, në regjistrin e shfrytëzuesve të ndihmave sociale kanë qenë gjithsej 27 389 familje me 113 842 anëtarë, përkatësisht individë, me kosto prej 2 milion e 84 mijë e 983 euro, ndërsa buxheti për skemën sociale është 27,2 milionë euro. Si informatë e përgjithshme rreth kësaj dhe pas informatave, edhe unë mendoj që kjo do të tentohet të ndryshohet. Personalisht mendoj se është diskriminues. Ashtu-kështu është paraparë edhe më herët në komision, është diskutuar edhe me grupet e ekspertëve dhe me atë të të drejtave të njeriut, por për shkak të buxhetit dhe implikimeve buxhetore kjo nuk ka hyrë në fuqi. Unë besoj që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, më fal, vazhdojeni nëse dëshironi!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: ...realisht, është një kriter diskriminues mendoj edhe unë personalisht, por duhet të shikojmë me Departamentin e Buxhetit, me Ministrinë e Buxhetit dhe me ju si të ndikojmë që ky kriter së paku të rritet moshë, në qoftë se nuk mund ta largojmë krejt, të tërin për shkak të implikimeve të mëdha, atëherë të shikojmë ta rritim moshën e fëmijëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Deputetja Xhevahire Izmaku, keni pyetje shtesë, apo pyetje tjetër?

XHAVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar! Faleminderit ministër për përgjigjen! Unë do të vazhdoj me pyetjen tjetër, e cila po ashtu lidhet me çështjet sociale, me projektet e punësimeve sezonale.

I nderuar ministër, vitin e kaluar ne i patëm disa iniciativa dhe nuk ditëm, së paku unë nuk e kam një informacion se sa persona kanë arritur që gjatë vitit 2014 të angazhohen në ndonjë projekt të tillë diku në shtetet e BE-së, duke i ditur po ashtu edhe vështirësitë e natyrës politike dhe pengesat që i kemi në këtë drejtim. Pyetja ime është kjo: Çka presim në këtë vit nga Ministria e Punës sa u përket punësimeve sezonale dhe a keni ndonjë strategji për realizimin e këtyre projekteve?

Në këtë drejtim, po ashtu më intereson ta di si bëhet selektimi i komunave pjesëmarrëse, sepse e kam një përshtypje që bëhet një koncentrim në qendrat më të mëdha dhe regjionale, pra mbeten komunat që janë më periferike, ku përfshihet edhe komuna e Vushtrrisë, duke e ditur faktin se më së pakti 1 520 familje janë në asistencë sociale. Faleminderit nëse e marr një përgjigje!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Ministra e deputetë,

Po e jap një pasqyrë të shkurtër të punës që ka ndodhur në vitin e kaluar, përkatësisht të departamentit përkatës të punës, mandej edhe një vizion ose ide, ose hapat konkretë që i kemi filluar gjatë këtij viti.

Në vitin 2014, duke marrë parasysh edhe ngërçin politik, nuk ka pasur edhe aq shumë suksese, por sidoqoftë dy projekte janë iniciuar dhe është filluar të punohet në ta. Projekti i parë ka të bëjë me punën sezonale të studentëve në Zvicër, i realizuar ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Organizatës “Agro-Impuls” në Zvicër, në kohëzgjatje prej 4 muaj, ku janë punësuar vetëm 2 veta. Projekti i dytë, që është pak më i madh dhe më i gjerë, ka të bëjë me punët praktike në infermieri në Cyrih të Zvicrës, i realizuar po ashtu ndërmjet Ministrisë të Punës dhe të Mirëqenies, Ministrisë të Punëve të Jashtme të Kosovës, Konsullatës në Cyrih, në kohëzgjatje njëvjeçare me gjithsej 81 aplikime, ku 10 prej tyre i kanë plotësuar kriteret.

Duhet theksuar, se në këtë projekt, në procesin e selektimit dhe rekrutimit të praktikantëve, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga punëdhënësi, domethënë Shtëpia e Pleqve në Cyrih, në këtë rast. Gjatë testimit njohuritë e kandidatëve dhe përzgjedhjen, që i kanë plotësuar kriteret e kërkuara me konkurs, njohja e gjuhës gjermane, niveli B-2, shkolla e mesme apo fakulteti, kanë qenë disa nga kriteret dhe përzgjedhja e tyre është bërë në koordinim me Ministrinë e Punës dhe me punëdhënësit.

Këto mundësi aplikimi në këto projekte, por dhe projekte të ndërmjetësimit në Botën e jashtme, që janë implementuar vitet e kaluara nga Departamenti i Punës dhe i Punësimit, përkatësisht Qendra për Shërbim të Emigrantëve dhe kanë pasur të drejtë të gjithë qytetarët e Kosovës. Shpallja ka qenë publike, e vendosur në tabelën e shpalljeve të zyrtare të punësimit dhe rrjedhimisht mundësi aplikimi kanë pasur dhe do të kenë të gjithë qytetarët nga komunat e ndryshme. Në këtë rast ka qenë komuna e Vushtrrisë, si përzgjedhje.

Ndërsa, në procesin e përzgjedhjes dhe rekrutimit të kandidatëve nuk ka pasur, në rastet tjera nuk ka pasur ndonjë kuotë regjionale ose komunale. Pra, nuk ka shpërndarje regjionale apo komunale, por procesi i rekrutimit dhe selektimit të aplikuesve bëhet në bazën e kriterëve profesionale të kërkuara në konkurs.

Në këtë vit, ndoshta është mirë të theksoj, unë kam filluar kontaktet me disa shtete, gjithashtu edhe me shtetin e Zvicrës dhe me fokus të veçantë në shtetet skandinave, sepse besojmë që ka mundësi që të arrihen punë sezonale, qoftë përmes punës dhe kthimit, qoftë edhe përmes ngritjes së shkathtësive dhe trajnimeve në disa sektorë të ndryshëm, në disa lëmenj të ndryshëm, që janë të nevojshme në tregun e punës së Kosovës.

Kemi filluar me shtetet skandinave dhe me shtetin e Zvicrës. Gjithashtu presim që edhe shtetet regjionale të hasin në mirëkuptim, pasi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ia vazhdo, të lutem!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Përfundimisht, kemi filluar kontaktet me shtetet skandinave dhe me shtetet e regjionit. Kontaktet, indikacionet e para janë pozitive. Duhet të kuptojmë, se kjo nuk është politikë e qëndrueshme dhe afatgjate, por sadopak do të ndikojë në mirëqenien e qytetarëve tanë, si në mirëqenien materiale, gjithashtu edhe në ngritjen e aftësive, për ata sektorë në të cilët do të punojnë në këtë vende. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! A ka pyetje shtesë? Atëherë, kalojmë në pyetjen e radhës. Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Ferid Agani.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është menaxhuese dhe ekzekutuese e Memorialit “Heroinat”, që i kushtohet kontributit të grave të dhënë gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Në fakt, ka kaluar shumë kohë, që kur do të duhej të ishte përfunduar dhe vendosur ky memorial në vendin e caktuar, që i është ndarë, por për arsye tërësisht burokratike kjo nuk ka ndodhur.

Si iniciuese e këtij projekti dëshiroj të informohem unë dhe publiku i gjerë, se çfarë po ndodh me këtë projekt, ku kanë arritur punimet dhe kur saktësisht pritet të përfundojë dhe të vendoset në lokacionin e caktuar?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar deputetë,
E nderuara zonja Lama,

Bazuar në iniciativën dhe kërkesën e grave deputete të Kuvendit të Kosovës, për ndërtimin e Memorialit “Heroinat” në Prishtinë, në shenjë nderimi të kontributit të gruas gjatë periudhës së luftës 1998-1999, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor ka zhvilluar procedurat për vlerësimin e ofertave për zgjidhje ideore dhe urbanistike për këtë qëllim, përmes konkursit publik, që rezultoi me përzgjedhjen e kompanisë “Molos-Group” (Prishtinë), për hartimin e projektit.

Në vijim, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor më datën 20 nëntor 2013 i është drejtuar komunës së Prishtinës me kërkesë për caktimin e lokacionit për këtë memorial.

Kuvendi i Komunës së Prishtinës me vendim të datës 7 maj të vitit 2014 e ka caktuar lokacionin për ndërtimin e memorialit dhe më datën 24 nëntor 2014 e ka lëshuar lejen për ndërtimin e tij, në pjesën e parcelës kadastrale nr. 6204, zyra kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe prej 60 m², në qendrën e qytetit, në rrugën “Luan Haradinaj”, në hapësirën publike ndërmjet Bankës Qendrore dhe Hotelit “Grand”. Kompania fituese është duke e finalizuar monumentin sipas kontratës, ndërkaq paralelisht ministria është duke zhvilluar procedurat për vendosjen e bazamentit, për të cilin me buxhetin e vitit 2015 janë siguruar mjetet e nevojshme financiare.

Vendosja e monumentit pritet të realizohet në periudhën prej mesit të marsit deri në fillim të prillit të këtij viti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! A ke pyetje shtesë, deputete?

ALMA LAMA: Faleminderit!

Zoti ministër,

Faleminderit për informatat! Unë e kam ndjekur në mënyrë të vazhdueshme, përveç kësaj periudhës kur nuk kemi qenë duke funksionuar si Parlament, se çfarë po ndodh dhe i kam ato informata, përveç kësaj të fundit që pritet që nga mesi i marsit e tutje. Në fakt, dua t’ju bëj një kërkesë.

Projekti është jashtëzakonisht i vonuar, që ta dini ju. Do të duhej të kishte përfunduar në 2013-ën, maksimumi në 2014-ën. Duhet që patjetër të përfundojë para datës 8 mars, në mënyrë që ne të planifikojmë që në këtë datë të vendoset, kështu që nuk besoj se është ndonjë ngushtim i madh dhe për Ministrinë, që kjo punë të kryhet, sepse më sa di unë, çështja ka ngelur tek vendosja e bazamentit, apo jo? Dhe, ju lutem na thoni se çfarë mund të bëni për këtë, që kjo punë të realizohet pak më shpejt, se me të vërtetë u bë jashtëzakonisht shumë kjo punë.

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Ministri, përsëri e ka fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Prej kohës kur e kam marrë mandatin e ministrit kemi qenë të kufizuar mjaft me mjetet në dispozicion nga buxheti i Kosovës. E dini që prej pas 15 janarit kam qenë në dispozicion dhe tash do të mundohemi, me siguri, që të provojmë këtë kërkesë, kjo është një kërkesë e natyrshme, e logjikshme. Do të provojmë ta akomodojmë brenda procedurave ligjore të prokurimit, të ndërmarrjeve, të cilat duhet ta

ndërtojnë atë bazament dhe do të bëjmë çmos që është e mundur, që ta realizojmë këtë kërkesë.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja deputete Alma Lama, ministri Kuçi nuk është këtu, a do ta parashtroni pyetjen e paraparë?

ALMA LAMA: Faleminderit! Zakonisht, i parashtroj pyetjet, por po e falë këtë herë ministrin Kuçi.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, po ashtu, pyetje për ministrin Kuçi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Atëherë, unë i kam parashtruar tri pyetje për ministrin Kuçi. Me Rregulloren e punës së Kuvendit kam të drejtë, që t'i parashtroj dy. Dhe, edhe përkundër faktit që i njëjti nuk është në këtë seancë, unë po e parashtroj pyetjen dhe të dyja.

Para disa ditëve, respektivisht më 20 janar të këtij viti, është mbajtur takimi i parë i grupit teknik për harmonizimin e legjislacionit për funksionalizimin e Gjykatës Speciale. Takimi i fundit i këtij grupi, u informuam nga mediet, që u mbajt diku në Prevallë dhe atë në mënyrën më të fshehtë, pra më tinëzare të mundshme.

Pyetja për zotin Kuçi është, se cila është arsyeja që ky takim të mbahet në këtë mënyrë, kur kihet parasysh se edhe draftet e dokumenteve përkitazi me Gjykatën Speciale janë duke qarkulluar nëpër zyrtarë të caktuar, pra përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, e që kjo realisht cenon kompetencat e ndara në mes të gjyqësorit dhe pushtetit ekzekutiv.

Deputetët e Kuvendit dhe qytetarët e Republikës, duhet ta dinë se çka po bisedohet në këto takime të fshehta e aq më shumë kur bëhet fjalë për një çështje të ndjeshme, siç është ajo për Gjykatën Speciale. Pra, Kuvendi dhe qytetarët duhet ta dinë se çka janë duke përmbajtur ato dokumente, cila do të jetë pakoja ligjore duke ditur që Gjykata Speciale e njollos luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Institucionet e Kosovës është dashur, që nëpërmjet legjislacionit ta mbrojnë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mirëpo ajo fatkeqësisht, nuk përmendet as në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, as në ligjet e aplikueshme, përveç në Ligjin për veteranët.

Unë pres përgjigje nga zoti Kuçi dhe gjithashtu ai do të jetë në dëgjim publik para Komisionit për Legjislacion, në lidhje me këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Dy pyetjet këto ishin, edhe një tjetër, të lutem, zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Raporti i rregullt vjetor i Auditorit të Përgjithshëm ka evidentuar se Administrata Publike në përgjithësi shumicën e lëndëve gjyqësore i ka të

humbura në procedura gjyqësore, ku si palë të paditura janë paraqitur institucionet publike të Administratës Publike në Republikën e Kosovës.

Pyetja për zotin Kuçi, meqë ky divizion për përfaqësim bie në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, pyetja është se cilat janë hapat, që i ka ndërmarrë kjo ministri për të funksionalizuar siç duhet Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror, në mënyrë që të ketë një përfaqësim sa më të denjë në gjykata për t'i mbrojtur institucionet publike, si dhe sa humbje apo dëmtim të buxhetit është shkaktuar, si rezultat i humbjes së kontesteve gjyqësore nga institucionet publike, për faktin se në raportin e Auditorit të Përgjithshëm përmenden humbja e miliona eurove në këto raste. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Ministri nuk është këtu. Vazhdojmë pyetjen e radhës. Vjosa Osmani ka pyetje për zëvendëskryeministrin Hashim Thaçi, i cili po ashtu, nuk është këtu. A doni ta parashtroni?

VJOSA OSMANI: Meqenëse, është çështje me interes të publikut, që ta dëgjojë përgjigjen nga ministri i Jashtëm, sepse ka të bëjë me numrin e saktë të njohjeve të Republikës së Kosovës, unë do të pres që ai të kthehet në Kosovë dhe të përgjigjet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Prapë zonja Osmani, ka pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Meqenëse, Asambleja Botërore e Shëndetësisë si organi më i lartë i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, do të mbajë takimin e rregullt të 68-vjetor, në maj të vitit 2015 dhe duke u nisur nga fakti se ky është organi suprem vendimmarrës, që vendos me shumicë votash, në këtë rast së paku 98, për anëtarësimin e një shteti të ri në këtë organizatë, pritet nga Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Jashtme të bëjnë koordinimin dhe lobimin e duhur për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë.

Koordinimi është veçanërisht pra, i rëndësishëm me MPJ-në, me Presidenten dhe Kabinetin e kryeministrit dhe është e nevojshme, që të bëhen kontakte edhe me shtete njohëse dhe ato jo njohëse, për të kërkuar votën e këtyre shteteve për anëtarësim në OBSH.

Mungesa e një koordinimi të tillë dëmton mundësinë që Kosova të aplikojë për anëtarësim në muajin prill, sepse siç e dini, sipas Statutit të kësaj organizate për t'u futur kërkesa në rend dite duhet të parashtrohet, së paku 30 ditë para mbajtjes së Asamblesë Botërore të Shëndetësisë, që do të jetë nga data 18 deri më 26 maj të këtij viti.

Pra, pyetja është, a ka bërë Ministria e Shëndetësisë koordinimin e nevojshëm për anëtarësim në OBSH dhe a është kjo kohë e mjaftueshme për ta përgatitur tërë këtë proces? A është ngritur ndonjë Komision ndërministror, ose ndërinstitutional, i cili do të merrej specifikisht me anëtarësimin në OBSH dhe, nëse po, cilat institucione janë të përfshira aty?

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, të lutem!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit, zonja deputete, për shqetësimin e ngritur për një çështje mjaft të rëndësishme për Kosovën, siç është anëtarësimi në Organizatën Botërore të Shëndetësisë!

Mund t'ju them se kjo çështje është ngritur dhe më parë dhe njëherësh paraqet një nga interesimet tona aktuale. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe, që ka anëtarësimi në këtë organizatë për Kosovën dhe shëndetësinë, si dhe nevojën e intensifikimit të bashkëpunimit dhe të integritit në të gjitha organizmat botërore.

Natyrisht, se jemi konsultuar me Zyrën e OBSH-së në Prishtinë dhe me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Kanë bërë që këto konsultime të rezultojnë, që ne të jemi të kujdesshëm në koordinim të gjitha aktiviteteve tona, me aktorët e përfshirë këtu, duke marrë parasysh edhe Zyrën e kryeministrit, Presidencën dhe gjithsesi, duke pasur parasysh në veçanti partnerët dhe miqtë tanë strategjik.

Komisione të posaçme deri më tash nuk janë ngritur për këtë çështje, sepse kemi konsideruar se më tepër do të jetë vendim politik i koordinuar me partnerët tanë ndërkombëtar, se sa çështje e vullnetit tonë të brendshëm. Natyrisht, ne e mirëpresim dhe jemi të gatshëm për çdo bashkëpunim dhe iniciativë, që lehtëson anëtarësimin në këtë organizatë. Do të jemi të angazhuar që në asamblenë botërore të shëndetësisë, që siç e tha do të mbahet në maj, Kosova të jetë e pranishme. Dhe, ju informoj se për këtë vit ne nuk do të jemi në gjendje të bëjmë aplikim, por e kemi të planifikuar që pas konsultimeve dhe harmonizimit të qëndrimeve, të aplikojmë në vitin e ardhshëm, domethënë në vitin 2016. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë? Po! Të lutem!

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Unë këtë pyetjen e njëjtë ia kam bërë ish ministrit të Shëndetësisë, saktësisht para 2 viteve dhe para 2 viteve ish ministri i Shëndetësisë ka thënë që është shumë afër që të përgatitet aplikacioni dhe nevojiten vetëm edhe disa muaj.

Mendoj që është shumë shqetësuese jo vetëm për Parlamentin e Kosovës, por duhet të jetë shqetësuese për Qeverinë që kjo çështje po zvarritet pa arsye vetëm shkaku i mungesës së punës dhe shkaku i mungesës së koordinimit, sepse nuk ka arsye që të mos paraqitet aplikimi për anëtarësim i cili siç e thashë duhet të bëhet në prill në mënyrë që kjo çështje të vihet në rend të ditës në maj.

Prandaj, ju inkurajoj që të bëhen përgatitje intensive dhe edhe një herë ta rishqyrtoni këtë pozicion që sa po e thatë që Kosova sivjet nuk do të aplikojë, sepse nëse nuk bëhet duhet të presim deri në vitin e ardhshëm, pra nga mesi i vitit të ardhshëm kur do të bëhet Asambleja e ardhshme e Shëndetësisë të kësaj Organizate.

KRYETARI: Faleminderit shumë zonja deputete! Vazhdojmë Lahi Brahimaj, pyetje për ministrin Memli Krasniqi.

LAHI BRAHIMAJ: Faleminderit, kryetar!
Meqenëse ministri nuk është këtu po e lë për seancën e radhës.

KRYETARI: Faleminderit shumë zoti deputet! Deputetja Aida Dërguti, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

AIDA DËRGUTI: Mosprania e kryeministrit dhe zëvendëskryeministrave sot, si dhe delegimi në nivel të ministrit shpërfaq ose frikë nga ballafaqimi me Kuvendin ose arrogancë. Sidoqoftë, kjo do t'i kushtojë shumë kësaj Qeverie.

Në një intervistë për Radio-Evropën e lirë, lideri i Listës Serbe Aleksandër Jablanoviq ka thënë se asociacioni i komunave serbe do të jetë me kompetenca ekzekutive dhe se për këtë janë në dijeni koalicioni qeverisës PDK-LDK dhe për të njëjtën çështje është dhënë premtim dhe është nënshkruar në marrëveshjen që PDK-LDK e ka bërë me Listën serbe.

Pyetja ime është: A mund të na tregoni se a ka marrëveshje të fshehtë për këtë çështje dhe me çfarë baze ligjore keni dhënë garanci për këtë çështje?

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Kërkon falje, ndërkohë ministri Abrashi e ka kompetencën të përgjigjet për kryeministrin.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!
Ministra,
Deputetë,
Me autorizimin e kryeministrit po jap përgjigjen e tij për deputeten Aida Dërguti nga Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”.

Me marrëveshjen mbi parimet bazë për koalicionin për Qeverinë e Kosovës në mes PDK-LDK dhe Listës serbe është paraparë të punohet në themelimin e asociacionit të komunave serbe. Me këtë marrëveshje nuk është marrë asnjë obligim se ky asociacion do të ketë kompetenca ekzekutive. Kompetenca të tilla nuk kanë qenë pjesë e asnjë marrëveshje me Listën Serbe, pa marrë parasysh deklaratat e individëve nga kjo listë.

Asociacioni i komunave do të jetë pjesë e dialogut ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, në Bruksel.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji mbi qeverisjen lokale nuk parasheh kompetenca ekzekutive të asociacioneve të komunave, prandaj as ky asociacion nuk mund të ketë përgjegjësi të cilat nuk i mundëson Kushtetuta dhe ligji në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja deputete, ke pyetje shtesë?

AIDA DËRGUTI: Po. Pse, çështja e asociacionit dhe kompetencave të tij është çështje e negociatave me Serbinë, për sa kohë kjo është çështje e brendshme e rregullimit të brendshëm të Kosovës?

KRYETARI: A ka mundësi edhe një herë ta përsëritni pyetjen për ministrin?

AIDA DËRGUTI: Çështja e asociacionit do të duhej të ishte çështje e brendshme e Kosovës dhe kush ju ka autorizuar që të bisedoni me Serbinë për kompetencat e këtij asociacioni?

KRYETARI: Zoti ministër, në qoftë se dëshironi, s'je i obliguar.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti Demiri, vendin e keni këtu, jo atje! S'jeni më deputet. Ju lutem, dilni në vendin tuaj.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit! Ashtu siç e ceka edhe më herët, edhe në përgjigje, kompetencat i rregullon Kushtetuta dhe ligji aktual për qeverisje lokale i cili është në fuqi. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, zonja deputete Dërguti, keni pyetje për ministrin Skender Hyseni.

AIDA DËRGUTI: Zoti ministër, më 27 janar u organizua një protestë paqësore në sheshin "Nëna Terezë". Siç e dini edhe ju, kërkesat kryesore ishin që të shkarkohet ministri në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Aleksandar Jabllanoviq për shkak të fyerjes që ia bëri shqiptarëve të Kosovës dhe për kthimin e projektligjit për ndërmarrjet publike që kombinatin "Trepça" e kthen në ndërmarrje publike.

Pyetja ime është: Në po këtë protestë u përdor gaz lotsjellës dhe plumba gome. Kjo edhe është e dokumentuar. Në një video, por edhe nga dëshmitarët e protestës është parë që një polic ka shtirë me armë zjarri në ajër, veprim i cili nuk ka qenë i nevojshëm.

Zoti ministër, a mund të na tregoni se çka keni ndërmarrë në lidhje me këtë çështje dhe a keni nisur hetimet për një veprim të paligjshëm?

KRYETARI: Faleminderit zonja deputete! Zoti ministër e ke fjalën.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete, zonja Aida Dërguti.

Faleminderit për pyetjen tuaj. Ndonëse pyetja e juaj bie në një fah ultraprofesional, do të përpiqem të jap përgjigje dhe në rast se ju prapë nuk do të jeni e kënaqur do të gjejme përgjigje adekuate të cilën mund t'ua jap edhe me shkrim.

Policia e Kosovës në përballje me turmat, në përballje me protestë, në përballje me çfarëdo tubimi publik, me kohë dhe në pajtim me kompetencat e saja, bën veprime të duhura, përgatitjet e duhura dhe planet e duhura operativo-taktike për të siguruar protestën.

Policia e Kosovës në protestën e fundit ka përdorë fillimisht sprejin OC dhe më pastaj ka përdorur edhe gaz lotsjellës, gjithnjë në pajtim me vlerësimin e vet policisë, vlerësimin profesional për nevojën e përdorimit të këtyre mjeteve për t'i parandaluar më tej shqetësimet dhe çrregullimet që kishin filluar.

Ky është vlerësim i Policisë së Kosovës, nuk është vlerësim i ministrit të Brendshëm.

Po kështu...po pritni se do të vi edhe të plumbat e gomës. Po kështu, Policia e Kosovës në një moment të caktuar ka vlerësuar se, dhe po e nënvizoj është vlerësim i Policisë së Kosovës, vlerësim profesional se duhej përdorur siç e quan Policia e Kosovës, municion kinetik e jo plumba gome. Dhe kjo është përgjigja je Policisë së Kosovës.

Kjo ka ndodhur pasi që koktej molotov dhe substancat tjera të zjarrta janë gjuajtur në drejtim të automjeteve të Policisë dhe me ç'rast ka filluar edhe djegia e topit të ujit.

Pra, bëhet fjalë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: I lutem regjisë është çështje sensitive, ka nevojë opinionin ta dijë.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Pra, sipas raportit që e kam marrë nga Policia e Kosovës, bëhet fjalë për municion kinetik me sfera të gomës përbrenda, zonja Dërguti. Bëhet fjalë për municion kinetik me sfera të gomës përbrenda që ka një gamë të kufizuar veprimi pasi që nuk hedhen nga arma e zjarrit por nga lancuesi i gazit lotsjellës dhe nuk kanë efekte vdekjeprurës. Pra, nuk bëhet fjalë për plumba gome me përbërje metalike në brendësi të tyre.

Kjo është përgjigja të cilën ma kanë dorëzuar ekspertët e Policisë së Kosovës dhe unë si ministër i Brendshëm nuk kam asnjë arsye të dyshoj në këtë raport profesional të Policisë së Kosovës. Pra, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me përdorim të plumbave klasikë të gomës me përbërjen metalike në brendësi, por kemi të bëjmë me municion kinetik sfera të gomës përbrenda. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja deputete ka pyetje shtesë, sa po shoh.

AIDA DËRGUTI: Po! Plumbat e gomës janë përdorur para molotovit, për sqarimin tuaj zoti ministër. Nuk e di çfarë raporti keni përpara dhe sqarimi tjetër është se plumbat natyrisht që janë kinetik se nuk mundën me qenë statikë. Prej këtyre plumbave është një protestues i cili është duke e humbur syrin në spital, këtu në QKUK, Uran Çarolli.

Pyetja ime shtesë është kjo: A merrni përgjegjësi si ministër i Punëve të Brendshme, për të gjitha veprimet që ka ndërmarrë policia në protestën e 27 janarit?

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Zonja deputete, ju siguroj që askush nuk mund t'i ikë përgjegjësisë për çdo gjë që ka ndodhur në protestat e ditëve të fundit, askush nuk amnistohet dhe nuk guxon të amnistohet nga përgjegjësia. Unë ju siguroj që të gjithë zyrtarët policorë të cilët kanë përdorur forcë sipas procedurave të brendshme të Policisë së Kosovës, janë të obliguar të raportojnë përdorimin e forcës.

Komisioni për analizimin e përdorimit të forcës është duke i shqyrtuar rastet e përdorimit të forcës nga policët që kanë qenë pjesë e operacionit. Pas analizimit të këtyre rasteve dhe për çdo shkelje që ky komision mund të konstatojë dhe hetimet janë në vijim, unë ju siguroj që konform ligjit do të iniciohen procedura të mëtejme dhe hetimet e brendshme do të fillojnë edhe nga Inspektorati Policor i Kosovës.

Unë ju ftoj dhe e ftoj çdokënd që mund të ketë prova që çojnë në një drejtim ose në një tjetër, e unë kujtoj që i vetmi drejtim duhet të jetë zbardhja e të vërtetës, konstatimi i fakteve e jo krijim perceptimesh, krijim mjegulle se ka ndodhur kjo ose ajo.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdojani fjalën ministrit, ju lutem!

MINISTRI SKENDER HYSENI: T'i ofroj Inspektoratit Policor dhe çdo institucioni tjetër të brendshëm në Ministrinë e Brendshme, që mbikëqyrë agjencitë dhe departamentet e ndryshme të policisë.

Unë ju siguroj që asgjë, po e theksoj, asgjë nuk do të fshihet ose anashkalohet dhe nuk jam këtu sot që të bëj analiza më të gjithanshme, më multidimensionale të asaj çfarë ka ndodhur, sepse qytetarët e Kosovës kanë pasur rastin dhe mundësinë që ta shohin live në televizion çfarë ka ndodhur.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Faleminderit për pyetjet! Pyetjet e deputetëve që nuk kanë marrë përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit, pra në bazë të nenit 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Të nderuar deputetë,

Pyes, nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 19 janar 2015, në orën 10:00, 19 janar 2015, në orën 17:00, 19 janar 2015, në orën 20:00 dhe 23 janar 2015 e vazhduar më 26 janar 2015.

Kush ka vërejtje le të urdhërojë? Po, zonja Haxhiu është lajmëruar.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë kam një vërejtje sa i përket procesverbalit të datës 19 janar 2015, ora 17:00. Nëse e lexojmë procesverbalin shohim siç është shkruar këtu, kur është kërkuar shmangia nga Rregullorja e Punës, ne kemi pasur dy votime siç edhe e dini.

Votimi i parë ka evidentuar që shmangia nga Rregullorja nuk ka kaluar, kjo nuk është shkruar në procesverbal. Dhe më pas keni kontrabanduar një votim tjetër të paligjshëm. Pra, unë kërkoj që kjo të evidentohet dhe të shkruhet që ka pasur dy lloj votime, e para në mënyrë elektronike, që ka rezultuar që nuk ka kaluar shmangia për Projektligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara e gjithashtu në këtë procesverbal duhet të evidentohet edhe lëshimi i sallës nga opozita, sepse siç e dimë pas kontrabandimit të shmangies së Rregullores së punës- votimit, opozita e ka lëshuar sallën për këtë arsye, kështu që kërkojmë në këtë procesverbal të jetë e evidentuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka vërejtje tjera. E ftoj administratën që t'i marrë parasysh vërejtjet e deputetes Haxhiu, për seancën e radhës.

Konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 19 janar 2015, në orën 10:00, më 19 janar 2015, në orën 20:00 dhe më 23 janar 2015, e vazhduar më 26 janar 2015. Domethënë, atë të datës 19 janar 2015, në orën 17:00, Administrata e sjell për seancën e radhës për verifikim. Faleminderit!

4. Interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, për përgjegjësinë e ministrit Aleksandër Jablanoviq për deklaratat e tij publike

Zonja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pikë e rendit të ditës është interpelanca për kryeministrin, por kryeministri as sot nuk ka ardhur ashtu siç nuk ka ardhur as ditën e marte që të përgjigjet para deputetëve, sepse të martën interpelanca ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Dhe në vend se të vijë dhe të institutanalizoj vendimin e tij ai ka preferuar të ikë nga interpelanca dhe të dal në një konferencë për shtypë pas dite.

Prandaj, sot më lejon i që para se të ndërmarrim veprime të mëtutjeshme të japë një kronologji të ngjarjeve.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e përkrahur nga partitë, pika është interpelanca, unë po e shfrytëzoj të drejtën time, ju mund ta shfrytëzoni të drejtën e juaj.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e përkrahur nga partitë e tjera opozitare, më 19 janar 2015, dorëzoi kërkesën për interpelancë, me një pikë të vetme, që ishte rekomandim i nënave të Gjakovës dhe qytetarëve të tjerë të vendit tonë, të cilët u ndien të fyer nga një cilësim shovinist të cilin e dëgjuam shumë herë nga një regjim i errët, i gjatë, i cili me dekada na cilësoi si egërsira.

Këtë herë, ky cilësim erdhi nga vartësi i Mustafës, nga një ministër i tij, i cili vazhdoi me arrogancë dhe ofendime për një muaj të tërë deri pardje.

Në interpelancën tonë ishte një rekomandim i vetëm, shkarkimi i ministrit Jablanoviq.

Kjo kërkesë u përkrah dhe u confirmua nga mijëra qytetarë të vendit tonë përmes protestave masive, të cilat prodhuan dhunë, lëndime, vuajtje fizike dhe shpirtërore.

Pra, sa i kushtoi Jablanoviqi Kosovës?

Them që i kushtoi shumë, i kushtoi gjak i cili u derdh në shesh, i kushtoi dëmtim të pronës, kushtoi me humbje edhe më të madhe të besimit, që do të thotë na kushtoi shumë, diçka që ka mundur të evitohet po të vepronte Qeveria dhe kryeministri dy orë pas kësaj deklarate.

Andaj, ky vendim edhe pse i duhur është jashtëzakonisht shumë i vonuar.

Dhe, vetëm pas një muaji pas shumë thirrjeve, pas shumë presioneve, pas protestave në rrugë, pas dhunës e cila na traumatizoi pamë që kryeministri më në fund, me një gjysmë fjale, në një konferencë për shtyp në të cilën nuk lejoi të ketë pyetje tha: filan-fisteku nuk është më ministër i Qeverisë.

Prandaj, si deputete dhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës dhe deputetëve të tjerë të opozitës, dua t'i shtroj disa pyetje këtu.

E para- Pse kryeministri Mustafa, sot nuk është këtu ? A është më e rëndësishme për te të jetë diku në Bruksel duke biseduar me Vuqiçin, duke i kërkuar falje për shkarkimin e Jablanoviqit apo duhet të vijë këtu dhe t'u tregojë deputetëve, të përgjigjet në disa pyetje të cilat kemi mbetur pa i marrë, si shoqëri, si Kuvend dhe si qytetarë të këtij vendi.

E para, dhe para se ta tërheqim këtë interpelancë, më lejoni të pyes: Pse nuk e kemi tekstin e arsytimit? Kryeministri Mustafa duhet të vijë sot dhe ta prezantojë në Kuvend, tekstin dhe arsytimin për çka e ka shkarkuar Jablanoviqin, për çka ai e ka shkarkuar, sepse ne e dimë për çka kemi kërkuar shkarkim.

E dyta, në cilën mbledhje të Qeverisë e keni marrë këtë vendim?

Dhe e treta, ju thërras, pasi që veç zëdhënësi i Qeverisë është këtu, të na e sjellin vendimin e nënshkruar dhe të protokolluar, që të sigurohemi se për çka bëhet fjalë, do të thotë, ka shumë pikëpyetje të cilave kryeministri Mustafa nuk u ka dhënë përgjigje në një konferencë e cila ka zgjatë 30 sekonda.

Dhe krejt për fund ja kujtoj kryeministrit Mustafa, po edhe gjithë Qeverisë se e ka përfunduar vetëm gjysmën e punës, sepse ka mbetur edhe “Trepça” dhe ne e thërrasim që të mos i detyrojë qytetarët që të dalin edhe një herë në protesta në mbrojtje të Kushtetutës dhe të ligjeve në fuqi, por ta sjell Ligjin për “Trepçën” në Kuvend, ta rikthej sepse ai është i gatshëm dhe është tërhequr nën presionin e Beogradit, në mënyrë që në formë institucionale të procedohet kjo kërkesë. Do të thotë kanë qenë dy kërkesa, gjysma e rrugës ka përfunduar, ka mbetur kërkesa e dytë, që është jo më pak e rëndësishme, e ajo është “Trepça”.

Dhe krejt për fund, po besoj që shkarkimi i këtij ministrit ka qenë një mësim për ministra të tjerë, por duhet të jetë mësim edhe për krejt Qeverinë dhe me theks të veçantë për kryeministrin, i cili nëse vazhdon t’i injorojë deputetët, Kuvendin dhe popullin, sigurisht që në protestat e radhës do të ketë thirrje për shkarkime të tjera. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Edhe pse nuk u tha unë besoj se e tërheqin kërkesën për interpelancë, sepse nuk ka objekt për të diskutuar. Dhe, ne si shefa të grupeve unë mendoj që duhet të flasim në emër të grupeve dhe këtu nuk duhet të ketë debat, sepse kjo pikë tash ka mbetur pa objekt bisede.

E para, zonja Kadaj në fjalën e juaj e kuptoj jeni deputete, e përfaqësoni një parti politike dhe nuk e mohoj të drejtën të bëni politikë, të bëni marketing dhe të thoni edhe gjëra që ... unë po flas në emër të Grupit...

KRYETARI: Të lutem, zonja Donikë, le të vazhdojë zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zonja Bujupi, s’ju kam ndërprerë, më lejoni të them mendim tim dhe të grupit dhe nuk ke nevojë për t’i dhënë zjarr kësaj pune se kot e ke, me një fjalor të tillë vetëm sa për të thënë diçka e keni gabim shumë, por është çështja e juaj, nuk po ju përzihem në atë, ju lus të them mendimin edhe qëndrimin e Grupit.

Ne, normalisht e përkrahim vendimin e kryeministrit për të shkarkuar zotin Jablanoviq, dhe vendimi është ushtruar ose detyra e kryeministrit e tij kushtetuese me përgjegjësinë më të lartë dhe e ka marrë një vendim të tillë.

Unë nuk hy të analizoj, sepse çdo gjë në protesta është parë, çdo gjë është e dukshme dhe askush nuk mund t’i ikë përgjegjësisë, kushdo çoftë ai, askush nuk mund t’i ikë përgjegjësisë. E kam thënë edhe po e them edhe sot kemi 1001 arsye për të protestuar në Kosovë, po ama asnjë të vetmen arsye nuk kem për t’ia thyer kokën askujt me gurë, me

gurë e as me dhunë, as me plumba të gomës. Dhe, kushdo që tenton të arsyetojë diçka të tillë, janë organet që duhet të konstatojnë këtë.

Nuk ka qenë gjysmë fjalë ajo që e dhënë kryeministri në konferencë. Unë nuk do të interpretoj këtë që e ka thënë, sepse është shumë e qartë. Nëse thuhet ai më nuk është ministër në Qeveri ose në Kabinetin e Qeverisë, Mustafa, Jablanoviq çka duhet tjetër të thonë. Pse nuk është sot zoti Mustafa, s'ka arsye që të jetë, sepse kjo pikë nuk është në rend të ditës ose s'duhet të jetë në rend të ditës, sepse ajo çka ka qenë kërkesë është realizuar dhe sa i përket tekstit ju duhet ta dini edhe besoj e dini, kryeministri i vendit në çdo kohë shkarkon edhe emëron ministra, zëvendësministra dhe asnjëherë nuk e ka obligim për ta sjell ty me shkrim, s'ka ndodhur kurrë as sigurisht nuk mund të ndodhë se s'ka arsye, ai nuk është më ministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Dhe, diçka po e them në seancë. Ju lus, mos manipuloni me Ligjin për "Trepçën". Ligji për "Trepçën" asnjëherë nuk ka qenë në seancë, sepse nuk është i përgatitur. Ju e dini, të nderuar deputetë që Grupi Parlamentar i LDK-së ka kërkuar debat dhe mbështetur nga të gjitha grupet tjera parlamentar, kemi nxjerr një rezolutë, ku është kërkuar të rregullohet me ligj të veçantë statusi i "Trepçës", kjo është e vërteta. Prandaj, kjo çështje duhet dhe mund të rregullohet vetëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në asnjë mënyrë tjetër.

Dhe, unë jam i bindur që Ligji për "Trepçën" pas përfundimit të Ligjit që do të jetë për ndërmarrjet publike, do të procedohet dhe statusi i "Trepçës", statusi juridik do të definohet qartë dhe për atë që ka dilemë eventuale, unë nuk kam dhe asnjë deputet e besoj i Parlamentit të Kosovës nuk ka dilemë, përpos atyre normalisht që nganjëherë mendojnë pak më ndryshe që "Trepça" është pasuri e jona, jo veç në territorin e Kosovës, është shumë e qartë që është në territorin e Kosovës dhe si të tillë ne me votën tonë, me ligjin që do ta miratojmë, nuk do të lejojmë të tjetërsohet dhe të bëhet e askujt tjetër.

Prandaj, unë ju lus që debatin, zoti kryetar me qenë se është fjala për tërheqjen e kësaj pike të rendit të ditës, ne si Grup Parlamentar normalisht e mbështesim, sepse nuk ka më objekt diskutimi për çështjen që është ngrit më herët. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë është lajmëruar zonja Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: E para, të gjitha vendimet e Qeverisë duhet të bëhen publike, këtu në Kosovë, jo në Beograd të shkohet për t'i treguar kryeministrit të Serbisë, po këtu në Kosovë, qytetarëve.

E dyta, ministrat votohen në Kuvend dhe po ashtu për shkarkimin e tyre në pyetjet e deputetëve duhet të përgjigjet kryeministri, është obligative.

Dhe, e treta, Ligji për "Trepçën" është tërhequr ditën e diel, në orët e vona të mbrëmjes, pasi që dy orë më herët është paralajmëruar kjo tërheqje nga Vuçiqi në Beograd.

Prandaj, mos u thirrni në atë që e keni shpëtuar “Trepçën” në fakt ju i keni shtyrë 18 muaj për të blerë kohë, sepse nuk keni pasur guxim të ballafaqoheni me një kërkesë të minatorëve, të grevistëve, të qytetarëve të Republikës sonë që “Trepça” të kthehet me pronësi të Qeverisë dhe Kuvendit, sepse është e jona. Ne e dimë dhe nuk do të lejojmë që ta tjetërsoni, mirëpo dallaveret të cilat po i bëni mos u mundoni t’i mbuloni me ligj. Pika 11.3 të cilën e keni sjell në projektligjin e dytë e dëshmon më së mirë që e keni lejuar me dorën e juaj që Leposaviqit t’i jepet e drejta të vendosë për “Trepçën”. Sigurisht që qytetarët nuk do ta lejojnë këtë dhe kjo do t’ju thuhet përmes protestave të radhës pasi që në Kuvend nuk jeni të gatshëm, s’mundeni dhe nuk keni guxim për t’u ballafaquar me deputetët. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Beqiri!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryesues!

Unë po e shfrytëzoj të drejtë dhe më nuk do të dal, sepse është shumë e qartë që vazhdohet të bëhet politikë e rrejshme, në seanca asnjëherë s’ka qenë Ligji për “Trepçën” mos manipuloni.

(Reagime nga salla)

Ju lus, Ligji për ndërmarrjet publike do të vijë në seancë dhe aty do ta debatojmë këtë që ju e thoni. Dhe, unë nuk dua të hyjë në kualifikime, sepse ju vetë po e thoni- do të vazhdojmë, kjo Qeveri kështu, kjo Qeveri ashtu. Po doni edhe një herë të tregoni se nuk është ose s’kanë qenë veç këto dy qëllime të juaja. Mos se Kuvendi është për t’i debatuar këto punë edhe këto ligje dhe unë nuk mendoj që është rruga dhe këtu do ta themi fjalën pra se kush po bënë dallavere kur të vjen ligji, ligji nuk ka ardhur, mos manipuloni Ligji për “Trepçën”.

Ligji për ndërmarrjet është në Komision, gjegjësisht ka kaluar në Komision, ju e dini këtë, është mirë për t’ju treguar, Projektligji për ndërmarrjet publike ka qenë në Komision dhe vihet në seancë në rend të ditës, e bisedojmë dhe e shohim kush po e mbron e kush nuk po e mbron të qenit “Trepça” e Kosovës, ashtu siç është. Dhe, mos u merrni me Vuçiqin, sepse ju ka bërë opsesion gjithkund, flitni për Vuçiqin, ky Kuvend vendos për “Trepçën”, po ju lus, ky Kuvend vendos për “Trepçën”.

(Reagime nga salla)

KRYESUESI: Regjia, shiheni minutat! Për fjalë, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, është paraqitur zoti Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për ministrat që janë aktualisht këtu,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dihet botërisht që të hënën është vendosur si pikë e katërt e rendit të ditës të jetë interpelanca me kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, zotin Isa Mustafa, për të debatuar në bazë të kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së. Ndërkohë,

fatmirësisht edhe unë besoj që ne duhet ta vlerësojmë që pikërisht fatmirësisht ka ndodhur ajo çfarë ka qenë kërkesë dhe është shkarkuar ai ministër dhe nuk po e shoh të arsyeshme që ne tash t'i kthehemi përsëri asaj çështje. Nëse kemi çështje tjera për trajtuar, nëse realisht mendojmë që përmes një çështje që themi çështje tjera, do të kemi kohë dhe sigurisht do të kem secili mundësinë edhe individualisht por edhe si grup parlamentar t'i parashtrojmë. Mirëpo, nuk jam për atë që të bëhet debat për një çështje e cila është mbyllur.

Kështu që unë në emër të Grupit e mbështes tërheqjen e kësaj kërkesë dhe besoj që atë që u tha edhe më herët, por që do të thuhet edhe në të ardhmen që ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, vërtet të jenë koshientë të zbatojnë Kushtetutën, ligjet e këtij shteti dhe mos ta bien as këtë Parlament, por as qytetarët e Kosovës në pozita të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje".

GLAUK KONJUFCA: Zonja dhe zotërinj,
Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,
Deputetë të Kuvendit,
Qeveria Mustafa e futi Serbinë edhe brenda Qeverisë së Kosovës, edhe brenda shtetit, kurse qytetarët e Kosovës po ikin jashtë.

Tash Isa Mustafa do të shkojë në Bruksel për t'u takuar me Vuçiqin. Ne e kundërshtojmë fuqishëm këtë takim të kryeministrit me Vuçiqin, pa u konsultuar me Kuvendin e Republikës së Kosovës. Po të ishte ai këtu, do ta kishte një rast të mirë për të na e sqaruar këtë gjë.

Ne nuk e dimë si deputetë të Kuvendit se çka do t'i thotë kryeministri Mustafa Vuçiqit. Ne nuk e dimë se çfarë do të paraqesë atje në Bruksel kryeministri Mustafa.

Çfarë pretendime do të paraqesë Serbia e çfarë plani ka Qeveria Mustafa për këtë takim? Pse të mos hapet këtu diskutimi, pikërisht këtu ku diskutohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës?

Isa Mustafa në një pikë të veçantë të kësaj seance, të cilën po e mbajmë, do të duhej të na kishte informuar hollësisht për temat të cilat do të ngritën, për çështjet përreth të cilave do të përballen pozicionet politike. Kështu siç po ndodh, që kryeministri shkon në Bruksel, takohet me Vuçiqin, bën kompromise dhe kompromiset që bëhen deputetët i kuptojnë në televizor, kjo definitivisht është një qasje jo vetëm joserioze, por para së gjithash antidemokratike.

Kur fliste Isa Mustafa se pse dëshironte të bëhej kryeministër, thoshte se këtë po e bënte që ta ndërronte qeverisjen dhe qasjen e Hashim Thaçit. Por, njëjtë si ky i fundit, kryeministri i tanishëm nuk i bisedon me deputetët e Kuvendit të vet, temat, sfidat, çështjet dhe problemet, të cilat do të trajtohen në dialog me Serbinë.

KRYESUESI: ... E kemi një temë tjetër... të mos e prishim seancën...

GLAUK KONJUFCA: Zoti Haliti, po a është e vërtetë që zoti Beqiri foli për “Trepçën”?

KRYESUESI: Po, po edhe ai e pati gabim!

GLAUK KONJUFCA: Edhe ai e pati gabim, se ai foli për “Trepçën” - më fal, nëse ai foli për “Trepçën”, me lejoni t’i kundërpërgjigjem një sekondë.

KRYESUESI: Mirë, mirë por nuk e kemi temë, ne jemi kolegë.

GLAUK KONJUFCA: E tash kjo do të thotë që Isa Mustafa nuk ka të drejtë të shkojë atje dhe të marrë vendime për drejtësinë në Kosovë, se si do të organizohet për shembull drejtësia e krejt shtetit të Kosovës në territorin e Kosovës dhe ne ta marrim vesh rezultatin e këtij kompromisi nga mediet.

Ajo për çka kemi nevojë, zonja dhe zotërinj, është që në Kuvend të vendosen vijat e kuqe në këtë Kuvend të asaj se çka nuk mund të negociohet fare. Si është e mundur, deputetë të nderuar që Kryeministri të vendosë se çka do të ndodhë me drejtësinë në Kosovë? Si mund të vendosë kryeministri Mustafa se cila gjykatë të hapet në veri e cila gjykatë të mos hapet në veri? Kjo, më falni nuk është kompetencë e tij dhe krejt këto vendime t’i merr krejtësisht duke e anashkaluar Kuvendin dhe deputetët e këtij Kuvendi të Republikës së Kosovës.

Shiheni, kjo gjë nuk reduktohet vetëm në relacionet Kosovë-Serbi, kjo çështje e prek thelbin e karakterit të shtetit tonë republikan. A po shkojmë kah Republika parlamentare a po shkojmë ka republikat qeveritare dhe me këtë sjellje të Isa Mustafës, ne e kemi përgjigjen e qartë. Ai po dëshiron këtë Kuvend ta kthejë në teatër të kukullave. U përmend edhe “Trepça” prej zotit Beqiri, Qeveria po thotë “Trepça” është në Kosovë, por shikojeni - edhe KEK-u është në Kosovë. A është KEK-u në Kosovë?

A e bëri Qeveria Thaçi e kaluar temë të negociatave dhe u vendos atje kush t’i mbledhë paratë e qytetarëve të Kosovës nga Elektro-Distribucioni i Serbisë? A është Telekomunikacioni në Kosovë, Telekomunikacioni në Kosovë është, por u bë temë e negociatave të Serbisë. Mitrovica, a është në Kosovë? Mitrovica në Kosovë është, askund nuk ka shkuar Mitrovica, por Mitrovica u nda. Edhe “Trepça” është në Kosovë, nuk për të shkuar askund “Trepça”, në Kosovë është, por shqetësimi me plot të drejtë i qytetarëve të Kosovës është që kjo Qeveri po përgatit një plan shumë të papranueshëm për “Trepçën”...

KRYESUESI: Glauk, një çështje tjetër, sa herë të doni ata duhet të vijnë.

GLAUK KONJUFCA: Pse nuk është Kryeministri Mustafa këtu, për t’i diskutuar me ne në mënyrë shumë demokratike të gjitha këto që po i ngrisin ne këtu. Dëgjoni, ne nuk kemi nevojë këtu për tellall, ne nuk kemi këtu për tellall të Qeverisë, ne kemi këtu për kryeministrin, i cili vjen këtu dhe thotë që, të betohet këtu para këtij Kuvendi:

“nëse”Trepça” vendoset në negociate me Serbinë, unë si kryeministër i Qeverisë së Kosovës jap dorëheqje”. Për këtë kemi ne nevojë ne si deputetë, për këtë kemi nevojë si Parlament i Republikës së Kosovës. Hajde, Isa Mustafa këtu dhe thuaj: “nëse “Trepça” ngrihet në negociata me Serbinë, unë jap dorëheqje”. Kjo është përgjegjësi, kjo është llogaridhënie.

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë vërtet ju kisha lutur, e kemi një çështje në diskutim është pika e rendit të ditës e interpelancës me kryeministrin lidhur me shkarkimin e ministrit Jablanoviq ose pretendimin për ta shkarkuar. Kërkesa është në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së. Publikisht e kemi dëgjuar të gjithë që shumica e partive kanë thënë kërkesit që nuk është temë më ajo në Parlament. Dhe, unë besoj që nuk është mirë që të shfrytëzohet foltorja për tema tjera. Ju e hapët një herë temën, por mendoj që deklarimi i kryetarëve të grupeve parlamentare ishte obligativ për ta mbështetur kërkesën ose vendimin që të tërhiqet kërkesa për interpelancë meqenëse nuk përbënë çështje. Sido qoftë, unë kam për detyrë procedurale që t’ua jap fjalën përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të “Nismës”, është paraqitur zoti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Sigurisht se çështja tashmë është konsumuar dhe vetë iniciuesi i këtij debati është tërhequr, por nuk mundem pa thënë në emër të “Nismës” se vendimi i Isa Mustafës nuk është i tij, por është vendim i qytetarëve dhe për një muaj rresht, Isa Mustafa si kryeministër ka qëndruar brenda shkeljes kushtetuese dhe nenit 94 të Kushtetutës, ku flitet për kompetencat e kryeministrit. Prandaj, edhe një herë po e përsëris se tërheqja në formën qysh e ka tërhequr nga Kabineti, zotin Jablanoviq, domethënë nuk ka qenë shumë e qartë dhe gjithsesi duhet ta përsëris se ajo ka ardhur si rezultat i qëndrimit shumë këmbëngulës të qytetarëve.

Në fakt, Isa Mustafa dhe komplet Qeveria nuk është dashur që këtë situatë ta lënë të acarohet deri në atë shkallë sa që të hidhen kubikë gurë në Sheshin “Nënë Tereza” dhe të krijohet një pasqyrë jo e mirë për Kosovën karshi faktorit ndërkombëtar. Kjo tregon se një kryeministër i pavendosur në vendime, domethënë sjell edhe anarki në shtetin tonë, në demokracinë që jemi duke e ndërtuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Për korrektësi, po ta jap edhe një herë fjalën, zonja Kadaj-Bujupi, por në qoftë se bën të jesh më decisive. A e keni tërhequr kërkesën për interpelancë, sepse unë nuk kam të drejtë ta tërheq e as ta hedh në votim e as ta ndali debatin. Unë nuk kam asnjë shprehje që ju e keni tërhequr përveç deklaratave publike...

DONIKA KADAJ-BUJUPI: I nderuar kryesues!

Ashtu siç e thashë edhe në hapjen e fjalës sime, po të ishte kryeministri këtu, po të vinte në interpelancë, po të zbatonte Kushtetutën dhe ligjet në fuqi duke u dhënë llogari Kuvendit dhe qytetarëve, po të jepte përgjigje në pyetjet të cilat ne i ngritëm, sigurisht që pas marrjes së përgjigjeve do ta tërhiqnim kërkesën për interpelancë, mirëpo injorimi të cilin kryeministri Mustafa po ja bën në rend të parë qytetarëve, atyre mijëra protestuesve

të cilët sot po presin ndoshta nga spitalet që të shohin se cila është përgjigja për kërkesën e tyre, dhe ai nuk vjen, na bën që ne të vazhdojmë dhe nuk do ta tërheqim kërkesën për interpelancë derisa Isa Mustafa të vijë në Kuvend dhe të japë përgjigje për pyetjet e ngritura nga deputetët.

KRYESUESI: Atëherë, konsideroj se nuk është tërhequr kërkesa për interpelancë . Ju kisha lutur që t'i përmbaheni kërkesës që e keni bërë që të mos kemi përplasje për shumë çështje dhe pastaj të mos vendosim asgjë, ose të mos luajmë të paktën me opinionin. Ne e dimë që opozita e ka për detyrë të thotë që është meritë e saj dhe e popullit që ka protestuar. Qeveria ka marrë vendimin, vendimi është publik, dhe edhe ata kanë për t'u përpjekur për ta menaxhuar situatën sipas asaj që mendojnë . Edhe unë jam dakord ta shoh vendimin e shkruar, se me siguri është diskutuar me mikrofona të hapur. Atëherë e vazhdojmë debatin, diskutimet për interpelancë...

(Reagime nga salla)

...Unë e filloj seancën, pikën e rendit të ditës nr. 4 që është interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës të Grupit Parlamentar të AAK-së për përgjegjësinë e ministrit Aleksandar Jablanoviq dhe deklaratat e tij. Grupi Parlamentar i AAK-së, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, Isa Mustafa.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në 3 orë. Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta, neni 44, pika 7 e Rregullores së Kuvendit. Në bazë të nenit 44, pika 8 të Rregullores së Kuvendit, kryeministri Isa Mustafa, paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash. Koha e ndarë për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve pa grup parlamentar, është si vijon:

- Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, 35 deputetë, 52 minuta e gjysmë,
- Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, 32 minuta,
- Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", 16 deputetë, 24 minuta
- Grupi Parlamentar i AAK-së, 11 deputetë , 16 minuta e gjysmë,
- Grupi Parlamentar Lista serbe, 10 deputetë, 15 minuta,
- Grupi Parlamentar "Nisma", 6 deputetë, 9 minuta,
- Grupi parlament "6 +", 6 deputetë, 9 minuta,
- Pa grup parlamentar, 4 deputetë, 6 minuta.

Këtu, nuk e llogarita zbritjen e minutazhit që është bërë nga Partia Demokratike, 6 minuta e gjysmë i janë dhënë shtesë kryeministrit dhe 5 minuta e gjysmë nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike.

(Reagime nga salla)

Nuk kam çka të bëj, nuk jam unë komandant këtu, veç në votim mund ta hedh nëse kërkon, Ismet!

(Reagime nga salla)

...Po, por rendi është i tjetërkujt - për procedurë, vazhdo!

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues!

Se vërtet nuk ka qenë qëllimi ose nuk është qëllimi ai që po proklamohet, po dëshmohej edhe tash. Jablanoviq është shkarkuar, dhe çka është ky maskemball, çka është kjo lojë politike, me kë do të bësh debat, por ligjërisht nuk plotësohen kushtet nëse nuk është kryeministri dhe nuk ekziston objekti për çka duhet diskutuar. Po merreni dhe lexojeni Rregulloren. Nuk është mirë të na vini në lojë edhe të mahiteni me qytetarët edhe me ne.

Unë po flas në emër të Grupit Parlamentar, ju bëni debat, interpelancë njëri me tjetrin, ne nuk e kemi ndërmend t'u dëgjojmë, sepse kryeministri i vendit e ka shkarkuar zotin Jablanoviq. Ju mund ta vazhdoni, mbani interpelancë pa ne, ia bëni veti qefin qysh po i bëni dhe ne nuk kemi asnjë arsye t'ju dëgjojmë ju për një objekt që nuk është objekt diskutimi, sepse kanë pushuar arsyet për çka është thirr. Thirreni kryeministrin dhe kënd të doni në interpelancë për çështje tjera, për zotin Jablanoviq, për ish-ministrin, pasi nuk e paskeni marrë vesh se nuk është më ministër, nuk keni nevojë të bëni debat edhe ne të pranojmë të jemi pjesë e debatit të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë nuk mund ta ndaloj interpelancën, sepse me Rregullore janë plotësuar kushtet. Në Kryesi, me kryetarët e grupeve parlamentare është marrë vendimi dhe nuk kam asnjë shkresë përmes të cilës është njoftuar Kryesia e Kuvendit që është tërhequr kërkesa për interpelancë. Sidoqoftë, unë kërkoj mirëkuptim meqenëse është edhe koha e drekës që ta marrim një pauzë prej një ore e gjysmë dhe , në qoftë se kryeministri është i gatshëm që të vijë, seanca fillon në orën 14:30. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Atëherë, në qoftë se jeni të pajtimit, do të kishim filluar. E ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në cilësinë e propozuesit të interpelancës, deputetin Daut Haradinaj, ta marrë fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç edhe jemi dëshmitarë, pas një situatë të krijuar në mes grupeve parlamentare, kur edhe kryeministri nuk gjeti kohë të bashkohet në Kuvend, ku edhe populli po ikë prej Kosove, kur edhe populli po fyhet dhe po zihet përgjegjës për protesta, në cilësinë e

ftuesit të kësaj interpelance, ne si grup parlamentar dhe si mbështetës po ashtu, e tërheqim këtë interpelancë. Shpresoj, që zoti Beqiri, je i kënaqur.

KRYETARI: Faleminderit, për mirëkuptimin! Atëherë, po vazhdojmë pasi më nuk ka arsye të vazhdojmë me këtë pikë të rendit të ditës.

5. Projektrezoluta për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës

Diskutimet lidhur me debatin për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 26 janar 2015.

Në ndërkohë, deputetja Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka proceduar tekstin e harmonizuar të Projektrezolutës me Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të “Vetëvendosjes” dhe Nismës.

Projektrezoluta u është shpërndarë deputetëve. Atëherë, ftoj kryetaren e Grupit Parlamentar të AAK-së, zonjën Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Siç e thamë edhe më herët, edhe në ditën kur e kemi mbajtur këtë debat, do të ishte shumë e udhës që Qeveria të jetë këtu edhe kryeministri, sepse ky dokument po prodhohet për t’u zbatuar nga Qeveria dhe nga kryeministri.

Situata është emergjente dhe shpërngulja po vazhdon edhe në këto momente, kur ne po flasim, prandaj konsiderojmë që të mos mbetet veç një rezolutë e shkruar, por në fakt të fillojë zbatimi i saj, sa më parë që të jetë e mundur.

Nëse më lejohet, unë para jush do t’i lexoj pikat një nga një:

Rezolutë

Për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës

1. Angazhim më i madh i Qeverisë së Republikës së Kosovës në zhvillimin ekonomik, me theks të veçantë në shtimin e vendeve të reja të punës për qytetarët e Kosovës.
2. Krijimi i Fondit për pengimin e migrimit ilegal.
3. Ndryshimi i politikave fiskale në përputhshmëri të plotë me kërkesat e kamotshme të bizneseve dhe lirimi i lëndës së parë nga taksa doganore dhe pagesa e brendshme e TVSH-së e jo në kufi, ende pa filluar përpunimi i mallit, ashtu që të rritet konkurrenca e prodhimeve vendore kundrejt atyre të importuara, me ç’rast do të shtohen vendet e punës.
4. Krijimi i menjëhershëm i lehtësirave doganore në përputhshmëri me rekomandimet e Komisionit Evropian të datës 22 tetor 2014, nga raporti final në përkrahje për Bordin e Pavarur të Kosovës për shqyrtime në fushën e doganave dhe akcizave.

Gjithashtu, duhet të anulohet menjëherë Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e koston së shpenzimeve të transportit të mallrave të importuara, i cili udhëzim është në kundërshtim të plotë me ekonominë e tregut.

5. Krijimi i menjëhershëm i lehtësirave doganore, tatimore dhe administrative për të gjithë ata, të cilët hapin më tepër se 10 vende të reja të punës.

6. Lirimi nga taksa dhe TVSH-ja e të gjitha makinerive apo pajisjeve dhe pjesëve rezervë, të cilat janë të dedikuara për prodhim ose përpunim të ndryshëm në Kosovë.

7. Lirimi nga taksa doganore i kompjuterëve, terminaleve, “Point of sale”, pajisjeve dhe arkave fiskale, ashtu që shkollat dhe bizneset të mund të pajisen me këto pajisje, që të ngritët efektshmëria në studim dhe në punë.

8. Subvencione reale dhe jo vetëm fjalë elektorale, për të gjithë prodhuesit vendorë, ose të interesuarit për të hapur biznese të reja në agrikulturë.

9. Angazhimi i Qeverisë nëpërmjet Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, për arritjen e marrëveshjeve me shtetet e Evropës për punësim sezonal të qytetarëve tanë.

10. Raportim në çdo tre muaj në komisionet parlamentare nga ministrat përkatës.

11. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia të obligohen të jenë aktiv dhe të veprojnë në ndalimin e rrjeteve kriminele të trafikimit.

12. Gjyqësori t’i zgjidhë rastet e trafikimeve në procedurë të përshpejtuar.

13. Ministria e Integriteteve ta intensifikojë fushatën vetëdijesuese rreth informimit të qytetarëve lidhur me migrimin ilegal, kërkimin e azilit dhe mundësitë e marrjes së vizave.

14. Qeveria të punojë në plotësimin e kushteve për liberalizimin e vizave, si mjet për pamundësimin e funksionimit të rrjetit të trafikantëve.

15. Qeveria të angazhohet për krijimin e kushteve dhe lehtësirave për biznese, si dhe për hapjen e vendeve të reja të punës në Kosovë dhe marrëveshjen ndërshtetërore për punësim nëpërmjet migrimit të kontrolluar legal të fuqisë së kualifikuar punëtore.

16. Të vazhdojë procesin e riatdhesimit të koordinuar me shtetet, në të cilat kanë emigruar qytetarët e Kosovës.

Kjo është pika e fundit. Unë ju falënderoj të gjithëve për debatin, të cilin e patëm javën e kaluar dhe ju thërras, që sa më parë ta kalojmë, ta procedojmë dhe ta votojmë këtë rezolutë dhe po ashtu, thërras ekzekutivin, që sa më parë të fillojë zbatimin e pikave nga kjo rezolutë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë, ndoshta edhe unë jam një nga ju, por realisht është një situatë... e di që edhe askush prej Kabinetit qeveritar nuk është në këtë sallë.

Si do që të jetë, ne po e vazhdojmë, po procedojmë, por do të ishte mirë që dikush prej Kabinetit Qeveritar të jetë këtu.

Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka fjalën Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kolegët deputetë!

Grupi Parlamentar ka marrë pjesë aktive në debat, ka marrë pjesë aktive edhe në Rezolutë, ka rekomanduar disa nga çështjet tjera, kështu që janë përbrenda kësaj rezolute. Mendojmë që është çështja më shqetësuese, aktualisht që e preokupon Kosovën dhe që do të duhej të merren shumë urgjentisht të gjitha institucionet, edhe Parlamenti, edhe Qeveria, edhe të gjitha institucionet tjera, është kjo çështje, kështu që e mbështet fuqishëm dhe do të jetë pjesë aktive edhe në mbështetjen e mëvonshme, nëse paraqitet nevoja, si grup parlamentar dhe si Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Elmi! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Edhe ne si grup parlamentar, siç edhe u tha nga zonja Kadaj-Bujupi që i keni harmonizuar edhe rekomandimet e edhe sot, sigurisht shprehim shqetësimin tonë për atë që po ndodh dhe besoj e uroj dhe të gjithë duhet të punojmë, që vërtet të realizohet, në mos e tëra ajo që thuhet aty dhe në Programin qeverisës, shumica e tyre, që ky trend negativ dhe kjo dhimbje që na ka kapluar si qytetarë të vendit, të ndalet.

Prandaj, ne si grup parlamentar i mbështesim këto rekomandime.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta përkrahë Rezolutën për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Meqë, situata është tejet shqetësuese, pra çdo natë po i shohim qytetarët tanë duke shkuar në vende të Evropës, është çështja urgjente, ku Qeveria, pra Ekzekutivi t’i zbatojë këto rekomandime menjëherë dhe urgjentisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma”. Hajde, urime Enver!

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse u tha që do të bëhet e shterë për këtë Rezolutë, në emër të Nismës, ne mbështesim këtë Rezolutë, por me disa shqetësime të cilat po vazhdojnë vazhdimisht të ndodhin për qytetarët e vendit. Nuk po më pëlqen fare, që po quhet migrim ilegal, sepse kjo është duke ndodhur një shpërngulje masive e cila është duke ndodhur në vendin tonë.

Ne ende nuk kemi asnjë informacion nga Qeveria, se sa është numri i të shpërngulurve, kështu do ta quajmë, sepse kështu është duke ndodhur. Është migrim ilegal për ndërkombëtarët, por jo për ne, të cilët në mënyrë më të dhembshme dhe më trishtuese përcillen me dhjetëra autobusë për çdo natë, para syve të shtetit, para syve të institucioneve të shtetit.

Prandaj, ne e mbështesim këtë Rezolutë dhe kërkojmë që Qeveria në afatin sa më të shkurtër të hartojë një plan veprimi, duke u mbështetur në këto pika dhe ai plan veprimi të përmbajë masa konkrete dhe të detajizuara për ndalimin dhe parandalimin e kësaj shpërnguljeje masive. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi “6+” Qerim Bajrami e ka fjalën.

QERIM BAJRAMI: Poštovani predsedavajući, Parlamentarna Grupa “6+” se slaže sa svim ovim zaključcima koje bismo trebali sada da usvojimo, s tim što na osnovu naših diskusija, kada smo dakle govorili o ovoj Rezoluciji, kao što svi dobro znate, mi smo imali i zahtjev da Vlada Kosova poradi i na nekim specifičnim problemima, koji se tiču direktno nevećinskih zajednica bošnjaka, turaka, roma aškalija i egipćana. I zbog toga, mi tražimo dakle da ovaj tekst koji ste dobili i u proceduri, se uvrsti u ove zaključke, dakle ove Rezolucije da bi smo mogli da glasamo za zajednički tekst Rezolucije. Hvala Vam!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, Lista Serbe nuk ishte askush, me sa po shoh, për atë arsye e kemi kaluar. Tani pa grup parlamentar, Donikë, po e shoh emrin tuaj këtu. Urdhëro, Donikë! Pastaj vazhdojmë pa grupe.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Desha vetëm të sqaroj për kolegun parafolës, që në Rezolutë, pas diskutimit edhe me kolegët tjerë, në fakt është theksuar si problem kyç ikja e qytetarëve kosovarë dhe kjo nënkupton, do të thotë, të gjitha etnive. Prandaj, nuk kemi nevojë të bëjmë dallime, sepse qytetarët e Kosovës janë të gjithë të barabartë dhe ikja e të gjithëve është shqetësim për ne dhe, kjo është arsyeja që në fakt është në të përgjithshmen dhe vlen për të gjithë ata që po ikin dhe po shpërngulen dhe po ikin rrugëve do të thotë ilegale.

Nuk ka nevojë të theksohet e një etnie, ose një tjetre, ose një tjetre, sepse ky problem në fakt është preokupim për të gjithë, njëjtë si për shumicën, si për pakicën.

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Atëherë, pasi që nuk është replikë, Danush ta jap fjalën të vazhdojmë me deputetët pa grupe. Shaip Muja, të përgatitet Emilija Rexhepi, pastaj Danushi. Emilija Rexhepi vazhdon, pastaj Shaipi Atëherë, derisa të ulet e të marr pozicion.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedniče!
Poštovani kolege poslanici,
Poštovani građani Republike Kosova,

I te kako je važno da podržimo Rezoluciju o sprečavanju ilegalne emigracije građana Kosova i u potpunosti se slažem sa poslanicom Donikom Kadaj, ali i manjinske zajednice imaju svoje specifičnosti, imaju svoje probleme, koje ih svakodnevno muče i što se direktno reflektuje i na iseljavanju odnosno na veliku migraciju našeg stanovništva.

Da ne govorim koji su ti problemi. Jako je važno da uvrstimo, imati i u napismenoj formi, dostavili smo sekretarijatu, da Vlada poradi na te specifične faktore i probleme koji nas muče. Ono što je i te kako bitno jeste da mi nećemo glasati za ovu Rezoluciju ukoliko se naš zahtev ne uvrsti. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit! Shaip Muja, të bëhet gati Danush Ademi.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Pa dashur, dua t' ju njoftoj se unë i kam minutat për sekretarinë nga deputetët tjerë të pavarur, do të thotë për 4-minutshin, që të mos jem i kufizuar, që i kanë deklaruar, mund edhe t'i deklarojnë.

XHAVIT HALITI: S'jemi në interpelancë, Shaip!

SHAIP MUJA: Zoti kryetar,
Pa dashur të...

KRYETARI: Vazhdo, mos i humb minutat. Vazhdo të lutem, se janë duke pritur...

SHAIP MUJA: ...unë mendoj që kjo rezolutë në disa pika është e qëlluar dhe është e miratuar edhe në legjislacionin e kaluar, por çështja Jablanoviq është një pasojë e shkaktuar, i cili është manifestuar ndoshta edhe nga ngërçi politik, që janë pjesëmarrës të gjitha partitë politike, pa dashur që të avokoj për Partinë Demokratike, të gjitha partitë tjera e kanë prodhuar produktin Jablanoviq dhe kanë prodhuar produktin anti neve të një pjese të pakicave, të cilat kanë qenë të integruara në institucionet e Republikës së Kosovës dhe Jablanoviqi nuk është përfaqësues i tërë komunitetit serb.

Prandaj, ne duhet të shohim, ky komuniteti i cili i ka pranuar institucionet duhet të shihen si përfaqësuesit e pjesës reale të integrimeve në Republikën e Kosovës. Dhe, për çështje tjera për të cilat sot ne duhet të bisedojmë, Jablanoviqi është përkrahur edhe nga "Vetëvendosja", edhe nga Isa Mustafa, edhe nga Aleanca dhe në këtë mënyrë është krijuar si një faktor i cili nuk është faktor, por faktorët janë diku tjetër, duke filluar edhe nga Vuçiqi, i cili ruan pakënaqësinë e vet sociale në Serbi, për ta transmetuar në Kosovë, ndërsa ne duhet të jemi vigjilentë për ato çka po veprojmë dhe çka po kërkojmë.

Prandaj të gjitha partitë e kanë humbur në një formë moralin dhe autoritetin edhe para popullatës dhe çdo moralizim që janë duke u munduar ta bëjnë, janë për poentim politik dhe për çështjen e një anëtarësie e cila veç i ka kuptuar mos e bëjnë një politikë pa moral të gjitha partitë politike, pa dallim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Shaip! Duhet bërë 6 deputetë, të kërkosh në emër të grupit. 5 je, ende pak. Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ne po e shohim këtu se të gjitha grupet parlamentare janë të përfshirë në idetë e veta për këtë projektrezolutë dhe po shohim Grupin Parlamentar të PDK-së, të LDK-së, Vetëvendosjes, “Nismës”, me përjashtim nuk di për çfarë arsye nuk janë marrë rekomandimet e Grupit “6+2.

Pra, i kemi pasur edhe ne 3 pika t’i shtojmë në këtë rezolutë, nuk e di për çfarë arsye, unë e di se është shqetësim për të gjithë qytetarët dhe ndoshta janë përfshirë shumë pika, por ne kemi, ndoshta 3 pika dhe ndoshta pak janë më specifike, të cilët kanë të bëjnë me migrimin ilegal dhe mu për atë po e shohim pak veten sikur të diskriminuar, por ndoshta se ishte një kërkesë nga Grupi Parlamentar i Listës serbe, që është këtu, ndoshta ishte marrë pak ma shumë parasysh dhe kishin diskutuar, ne po e shohim të arsyeshme, për çfarë arsye nuk po merret kërkesa e Grupit tonë parlamentar “6+” së paku të diskutohet që janë 3 pika, që i kemi kërkuar.

Dhe, ndër këto 3 pika janë, njëra prej pikave që më së shumti është duke i prekur qytetarët, është të diskutohet rreth ligjit, të merret parasysh ndryshimi sa më shpejt i Ligjit 4/L-096 pika 4.5 së paku rreth ndryshimit sa më shpejt të Ligjit për skemën sociale dhe një pikë më së shumti ndoshta na prek të gjithëve, që ne nuk po e shohim fare që ndoshta është e prekur në rezolutë, duhet të ndahet fondi i veçantë për familje që kthehen nga vendet evropiane, sidomos për këto të riatdhesimit.

Për çfarë arsye jam duke e thënë këtë? Jam duke e thënë, sepse ne kemi pasur një takim, me ministrin e Kthimit, javën e kaluar dhe ministri i Kthimit tha: nuk kemi asnjë fond të veçantë për këto familje, që kthehen dhunshëm apo vullnetarisht, që kthehen prej vendeve të treta, mu për atë ne edhe kemi dalë me një rekomandim që së paku për të gjithë ata që kthehen tash në mënyrë të dhunshme apo në mënyrë vullnetare ndahet një fond specifik për këto familje.

Kjo është kërkesa që ka qenë dhe nuk ka qenë ndoshta një kërkesë shumë specifike apo që është në kundërshtim me ligjin, por nuk e di për çfarë arsye nuk janë marrë parasysh kërkesat tona.

KRYETARI: Faleminderit! Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Ja mogu da razumem gospođu Doniku i sve one ljude sa kojima se ona konsultovala i ja se slažem sa tim da smo i mi stanovnici Kosova isto kao i svi ostali ali pitam gospođu Doniku i sve ostale sa kojima se konsultovala da li ona zna da polovina i naših roditelja iz Bošnjačke zajednice su napustili Kosovo zbog toga zato što im deca u srednjim školama nemaju nijedan udžbenik na bosanskom jeziku, a sa time se naravno ne susreće niko na Kosovo osim nas, i da li ona zna da su naši intelektualci napustili Kosovo možda u broju od 60 intelektualaca zbog toga zato što nisu imali ni priliku da apliciraju za posao a svi drugi imaju priliku.

Ovo su neki specifični problemi i ja razumem da smo mi kosovari i razumem da delimo sudbinu svih ljudi na Kosovu ali i vi trebate da razumete gde mi imamo neke specifične probleme na kojima treba specifično da se radi jer se tiču isključivo i samo nas. I zbog toga smo želeli da se ova tačka uvrsti u rezoluciju i istrajaćemo na tome i naravno da je ova rezolucija je dobra i sam za tu rezoluciju ali vas molim da dobro razmislite da ova tačka nikoga neće oštetiti ukoliko se nalazi u rezoluciji a nama će mnogo pomoći jer će u odnosu na tu rezoluciju Vlada biti u neku ruku primorana da razmisli o našim problemima. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të lajmëruar për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk është. Atëherë, futemi në pjesën të vazhdojmë me votimin e Projektrezolutës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e Projektrezolutës dhe votojmë tash.

Konstatohet se në votim morën pjesë 73 deputetë, nga të cilët 69 vota janë për, 2 kundër dhe 2 abstenime dhe miratohet Rezoluta për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

6. Propozimin për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Në bazë të nenit 11 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, Kuvendi formon Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Ftoj kryetarët apo përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc.

Komisioni ad hoc përbëhet prej 9 anëtarëve. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, i ka propozuar 2 emra.

Atëherë ftoj Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që të propozojë një deputet për kryetar të Komisionit dhe një deputet për anëtar të Komisionit, për arsye se kanë ardhur edhe emra, sikur që thashë.

E ka fjalën Elmi Reçica, nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në bazë të nenit 71 dhe 63 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka marrë vendim që në Komisionin ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media të propozojë:

- Për kryetare dhe njëkohësisht anëtare, Xhevahire Izmakun, deputete, dhe
- Anëtare të dytë, deputeten Blerta Deliu.

E kemi bërë një ndryshim për shkak se Zenun Pajaziti, është jashtë vendit, për atë arsye. Faleminderit !

KRYETARI: Faleminderit shumë! Atëherë, Ismet Beqiri, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, 2 deputetë për anëtar të Komisionit, zëvendësin. Nuk po specifikohet këtu, por ju kur i propozoni i propozoni specifikisht... Urdhëro! Zëvendësin e paska “Vetëvendosje” kështu po shkruan. Kërkoj falje në procedurë.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Ne për anëtar të këtij komisioni e propozojmë deputetin Sadri Ferati dhe deputeten Alma Lama.

KRYETARI: Faleminderit! Ftoj kryetarin apo përfaqësuesin e Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” që të propozojë një deputet për zëvendëskryetar të parë të Komisionit. Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!
Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” propozon deputeten zonjën Shqipe Pantina në Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e propozon 1 deputet për anëtar të Komisionit.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!
Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e propozon deputetin Pal Lekaj.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+” le ta propozojë një anëtar, një deputet për zëvendëskryetar të dytë të Komisionit, pasi Lista serbe nuk është.

MYFERA SHINIK: Te shekyr ederrim. “6+” parlamentar grubu bu komisiona miletve ve kili Kujtim Paçaku domer mektedir. Teshykyr ederim!

KRYETARI: Faleminderit! Ftoj Grupin Parlamentar Nisma, që të propozojë 1 deputet për anëtar të Komisionit.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!
Nisma, propozon deputetin Enver Hoti.

KRYETARI: Faleminderit ! Vazhdojmë me votim.

(Ndërhyrje)

Urdhëro, zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Unë kam një pyetje. Ju thatë që Grupi Parlamentar i PDK-së propozon kryetaren dhe zëvendësin. Më pas neve na ra që të propozojmë zëvendësin e parë.

Tash a mund ta di se në bazë të cilës formulë po ia jepni të drejtën e kryesimit Grupit të PDK-së?

(Ndërhyrje)

Veç anëtarë, sepse ju thatë, kryetar. Kështu që ne këtu do të duhet të votojmë vetëm për anëtarët të këtij komisioni, jo edhe për kryetar.

KRYETARI: Vetëm pak të kemi parasysh. Mund të kam gabuar edhe unë, ka keqkuptim ose edhe një herë ta përsëris.

Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar 1 deputet për kryetar dhe 1 deputet për anëtar të komisionit.

(Ndërhyrje)

Për arsye se qenka grupi më i madh parlamentar. Po nuk e kam vendosur unë. Për hir të publikut nuk është vendim i kryetarit. Kjo është një pjesë e cila ka ardhur nga Administrata kështu. Aktivizojë të lutem folësen! Regjia, mikrofonin!

ALBULENA HAXHIU: Disa herë kemi diskutuar për këtë çështje në mandatin e kaluar dhe jo domosdoshmërisht të gjitha komisionet ad hoc i takojnë grupit më të madh parlamentar.

Unë po propozoj që ky Kuvend të votojë për anëtarë të këtij Komisioni ad hoc, ndërsa komisioni si komision, me konsensus ose me vota le të dakordohen se kush do ta kryesojë këtë komision ad hoc.

KRYETARI: Megjithatë, të mos futemi në konfuzion, jemi para situatës së votimit. Nuk ka qenë diçka që unë e kam zgjedhur, dhe këtë ta keni parasysh. Ky është një proces të cilin e kam ndjek në mënyrën se si më është servuar nga Administrata dhe në bazë të Rregullores.

Po vazhdojmë dhe ju kisha lutur regjisë e deputetëve të përgatiten për votim.

(Ndërhyrje)

Arbeni e njeh shumë mirë Rregulloren dhe përvojat. Arben, e ke fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk jam shumë i lumtur që PDK-ja po e udhëheq këtë farë komisioni, por Rregullorja e punës thotë që komisionet e Kuvendit reflektojnë përbërjen politike të Kuvendit.

Kjo nënkupton që forca politike në Kuvend në komision duhet të jetë sipas forcës politike në Kuvend, që nënkupton pozita e udhëheq komisionin, e opozita përveç kur bëhet fjalë për komisione hetimore ose komisione tjera. Komisionet ad hoc reflektojnë përbërjen e Kuvendit, prandaj kjo është zgjidha e cila është ofruar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ! Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e Komisionit ad hoc dhe votojmë tash.

Konstatohet se në votim morën pjesë 76 deputetë, nga të cilët 74 kanë votuar për, 2 kanë abstenuar dhe nuk ka vota kundër.

Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media.

7. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për emërimin e anëtarit në komisionin parlamentar

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka propozuar deputetin Rexhep Selimi, anëtar në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Procedojmë me votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Ju lutem, të votojmë tash. Është formalisht, por qenka e obliguar, po u deshka të votohet.

(Ndërrhyrje)

Ju lutem, votoni tash. Është çështje formale, sido që të jetë. Kaloi.

Mundësisht, kur jeni pa kartela, paraprakisht, sot nuk është kontestuese por kur po ka kontestuese pastaj nuk po pranohet ajo votë, përpara, veç në fillim. Faleminderit shumë!

Atëherë, me 62 vota për, 2 kundër miratohet propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për emërimin e zotit Rexhep Selimi, anëtar në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

8. Propozimi i Grupit Parlamentar të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarit në komisionin parlamentar

Grupi Parlamentar Lista Serbe ka propozuar deputetin Slavko Simiq, zëvendës kryesues të dytë në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur dhe Peticione, në vend të deputetes Jasmina Zhivković.

Edhe kjo është një çështje formale, duhet ta votojmë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

Faleminderit. 50 veta kanë votuar. 48 janë për, 2 abstenime, nuk ka kuorum për vendimmarrje.

Me këtë deklaroj përfundimin e seancës së sotme. Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë